

AGJËRIMI

EDUKATË DHE VETËNGADHËNJIM

Muhammed
Abdullah
Draz

Logos-A



Dr. MUHAMMED ABDULLAH DRAZ



Në emër të Zotit bamirës dhe të mëshirshëm

AGJËRIMI

EDUKATË DHE VETËNGADHËNJIM

Si rast ideal, rrugë unike dhe shprehje e manifestimit të përkushtimit të jashtëzakonshëm, vetëmohimit dhe vetëngadhënjimit, maturisë dhe vazhdimësisë, modestisë dhe bujarisë, pendimit dhe frymëzimit, pastërtisë së shpirtit, përkushtimit ndaj Kur'anit dhe përsiatjen rreth All-llahut xhel-le shanuhu.

Logos-A - Shkup
1999/1420

Biblioteka *Mendimi islam*

Titulli në origjinal
Es-Sawmu – terbijjetun we xhihadun

Përktheu nga gjuha arabe
Mes'ud Hafizoviq

Shqipëroi nga boshnjakishtja
Nexhat Ibrahimimi

ISBN 9989-904-02-2

Dr. MUHAMMED ABDULLAH DRAZ

AGJËRIMI
EDUKATË DHE VETËNGADHËNJIM

MUAJI I UDHËRRËFIMIT DHE MËSHIRËS

Muaji i bekuar

Kaloi edhe një vit... Përsëri u kthye Muaji i Bekuar i Ramazanit. Na u kthye meqë shumë diçka kemi harruar, nuk e kemi përfillur pasi që me të madhe u jemi përkushtuar preokupimeve të kësaj bote.

Na u kthye Ramazani dhe ne sërish kemi fat që me më shumë shpirt t'i përkushtohemi ibadetit, t'i jetojmë ditët e tij shumë të bukura dhe netët shumë të ndritshme...! Ç'mendoni, a do të jetojmë edhe kaq dhe përsëri ta presim atë, apo ndoshta në këtë distancë të shkurtër kohore vdekja do të na arrijë dhe ne, ndoshta, më nuk do të takohemi?

A thua ka njeri të cilit All-llahu i garanton se do t'ia zgjasë jetën, e që edhe vitin e ardhshëm i shëndoshë, me gjendje të mirë materiale, i sinqertë në qëllim, i matur në vendim, ta presë Ramazanin. Por, pasi fati është i panjohur dhe i fshehtë për të gjithë ne, pasi vdekja vjen vetëm për një çast dhe pasi ky çast i caktuar vjenë befas, është një veprim

i marrë të shitet ardhmëria për të tashmen, të zëvendësohet bindja me dyshim...!

“Ç’mendon ti, nëse Ne u lejojmë që me vite të dëfrehen dhe në fund t’i gjejë ajo me çka kërcënohen, a thua do të kenë diç nga jeta e ëmbël të cilën e kanë kaluar?” (Esh-Shura, 205-207). **“E pse ata nuk mendojnë për Zotin e qiejve dhe të tokës dhe për tërë atë që Ai e ka krijuar, ndoshta fundi i tyre u është afruar? E në cilat fjalë, nëse jo në Kur’anin, ata do të besojnë?”** (El-A’raf, 185). Dhe vallë në cilin rast ata shpresojnë? A thua çdo njëri nga ne do të presë derisa nuk do t’i vijë dita në të cilën do të thotë:

“Sunduesi im, më kthe të bëj ndonjë të mirë në atë që e kamë lënë!” (El-Mu’minune, 99-100). Ose do të thotë:

“Sunduesi im, edhe vetëm pak kohë të më mbashë, që sadakë të ndajë dhe i mirë të jem!” (El-Munafikun, 10).

Jo, kjo nuk do t’i mundësohet askujt. Është e nevojshme që fuqimisht të vendoset dhe të jepet çdo gjë nga vetja, që Ramazani të shfrytëzohet si rasti më i mirë që njeriu t’i përkushtohet ibadetit dhe të bëjë vepra të mira.

Po, ky vërtet është rast i shkëlqyeshëm. A nuk e dini se gjatë vitit është një periudhë që është më frytdhënëse se periudhat tjera, në të

cilën gjelbërohen kurorat e drurëve dhe lulet lulëzojnë, periudhë në të cilën fara më lehtë mugullon dhe jep fryte dyfish ose shumëfish më tepër? Kjo është pranvera, të cilën bujqit me gëzim e presin që në të t'i mbjellin arat e tyre dhe t'i kryejnë punët tjera që kanë të bëjnë me agrarin.

Kështu është edhe me Muajin e Bekuar të Ramazanit. Ai është pranverë për shpirtrat. Vlera e çdo vepre të mirë dhe pune të dobishme të cilën e bën njeriu në këtë muaj, rritet dhe zhvillohet vrullshëm. Agjërimi, namazi, veprimet e dobishme, format e ndryshme të dhënies e ndihmës dhe synimet tjera mirëbërëse, janë të bekuara dhe sjellin shpërblim të shumëfishtë. Mjafton vetëm ajo që brenda këtij muaji të bekuar është Nata e Kadrit. **“E ç’mendon ti, ç’është Nata e Kadrit? Kjo natë është më e mirë se një mijë muaj.”** (El-Kadër: 2-3).

Ndër ne ka edhe shumë të tillë të cilët deri më tash i kanë lëshuar këto raste, e kjo është koha e vërtetë që të inkuadrohen në radhët e musal-live (faltarëve), para se krejtësisht ta humbin rrugën e vërtetë.

E çfarë mundësi të shumta u ofrohen atyre të cilët në ditët e Ramazanit rregullisht praktikojnë që ta shumëfishojnë angazhimin e

tyre, që të japin sa më shumë nga vetja dhe të jenë sa më afër idealeve të tyre.

Mirëpo, puna e parë që medoemos duhet ta bëjmë kur ta dëgjojmë këtë thirrje është që të kthehemi pak mbrapa dhe vetë në mënyrë kritike t'i analizojmë rëniet, lajthitjet dhe rrëshqitjet tona të deritashme, e pastaj të pendo-hemi me një pendim të sinqertë për lëshimet që i kemi bërë ndaj Sunduesit tonë të fuqi-shëm, të vendosim me një këmbëngulje të thellë që së paku në të ardhmen të jemi lojalë, të zellshëm dhe të qëndrueshëm. Ky është hapi i parë drejt përgjigjes ndaj thirrjes së All-llahut xh.sh., dhe ky është thelbi i pendimit të cilin All-llahu e ka bërë garanci të sigurimit dhe shpëtimit në këtë dhe botën tjetër, sikur që vetë All-llahu, duke iu drejtuar Të Dërguarit të dashur e të mëshirshëm, Muhammedit a.s., thotë: **“All-llahu ata s'i ka dënuar, sepse ti ndër ta ke qenë; dhe All-llahu nuk do t'i dënojë derisa ndonjëri prej tyre të lutet me një pendim të thellë që t'i falen mëkatet e bëra.”** (En-Enfal, 33). Domethënë, Ummeti (popullata) atëherë ka pasur dy mbrojtës nga fatkeqësia: i pari, prania e Të Dërguarit në mesin e tyre, dhe i dyti, pendimi i tyre i sinqertë për mëkatet. Mbrojtësi i parë që moti nuk është në mesin e të gjallëve të kësaj bote, kështu që na ka mbetur vetëm mbrojtësi i

dytë, e nëse edhe këtë e humbim për shkak të mëkateve tona, shkeljes së parimeve e dispozitave islame dhe vazhdimit në të këqija e gjëra të ndaluara, do ta humbim kuptimin e vetë jetës sonë, aftësinë e gjykimit të shëndoshë, qetësinë dhe sigurinë tonë shpirtërore, ndërsa pa këto nuk mund të ketë as besim të mirëfilltë .

Pra, aksionin tonë në këtë muaj të bekuar le ta fillojmë me pendim të sinqertë, me largimin e çdo gjëje të shëmtuar dhe me shmanjen nga çdo mëkat: **“O Zot, na fal! O Zot, vetë jemi fajtorë ndaj vetvetes, dhe nëse Ti nuk na falë e nuk na mëshiron, ne me siguri do të jemi të humbur!”**

Kur këtë hap të gabuar ta përfundojmë me pendim dhe kthim drejt pastërtisë, na mbetet që ta vazhdojmë, ta zbukurojmë, ta përkryejmë dhe ta ndërtojmë këtë synim pozitiv. Po, pasi që t'i pastrojmë zemrat nga errësira e epsheve dhe punëve të liga, duhet t'i mbushim me dritën e urtësisë. Ramazani nuk është vetëm muaj i përmbajtjes dhe i luftës. Ai është diç më shumë se kjo, është muaj i udhërrëfimit e mëshirës..., udhërrëfimit e mëshirës që janë dërguar nga qielli.

Në këtë muaj të bekuar shtëpitë e Zotit janë përplot faltarë, lexues të Kur'ani, udhërrëfyes. Aty ka besimtarë që kërkojnë por

edhe besimtarë që e duan udhëzimin... Në këtë muaj zemrat e besimtarëve janë përplot mëshirë, ngrohtësi dhe mirësi ndaj varfanjakut, të rrezikuarit në pikëpamje sociale, jetimit dhe udhëtarit qëllimshëm. Ja, ky është udhërrëfimi dhe kjo është mëshira të cilat, duke iu falënderuar diturisë islame, janë shpërndarë anembanë rruzullit tokësor.

Në këtë muaj të bekuar u zbrit Kur'ani, që është rrugë drejtimi për njerëzit, sprovë e qartë e rrugës së drejtë dhe dallimit të mirës nga e keqja. Në të derdhet mëshira dhe plotësohen lutjet: **“E kur robtë e mi të pyesin për Mua, thuaju se Unë jam vërtet shumë afër: i përgjigjem lutjes së lutësit kur të më lutet...!”** (El-Bekare, 186). Ja, ky është udhërrëfimi dhe kjo është mëshira që janë dërguar nga qielli.

O Zot, na bënë të denjë për mëshirën Tënde dhe na frymëzo që ta ndjekim për-udhjen Tënde!

Pritja e Ramazanit

Shfaqu oj Hëna e re e Ramazanit! Shfaqu, sepse sytë gjithnjë janë drejtuar lart në qiell duke pritur çastin që të të shohin. Sytë e besimtarëve janë plot dashuri duke shikuar

daljen tënde. Disa që nuk e kuptojnë rëndësinë dhe veçanësinë e bukurisë sate, vërejnë: **"Ç'është dashuruar aq shumë kjo zemra jote në Hënën e re të Ramazanit? Fundja, edhe ajo është sikur edhe Hënat tjera të reja?"**. Por, ata nuk e dinë se ti je lajmëtare e muajit të veçantë dhe si e tillë, për zemrat tona je një frymëzim i madh.

Le të shikojnë ata në harkun e ndritshëm posa të shfaqet. A nuk po shohin se krahët e tij janë të kthyer drejt njëri-tjetrit? Pastaj le ta vëzhgojnë çdo mbrëmje! A nuk po shohin se krahët e atij harku i afrohen njëri-tjetrit, derisa përfundimisht nuk bashkohen? A nuk gjejnë në të një frymëzim të thellë dhe a nuk dëgjojnë thirrjen e saj të fshehtë?

Me këto domethënie sigurisht do të ngazëllehet ai, të cilit Hëna e re mund t'i jetë frymëzim. Mirëpo, këto domethënie në historinë tonë islame janë të lidhura me Ramazanin, në të cilin edhe filloi Shpallja, në të cilin është Dita e Bedrit dhe në të cilin është edhe Nata e bekuar e Kadrit.

Shfaqu oj Hënë e re e Ramazanit! Le të jetë lindja jote për Islamin nga horizonti i fuqisë dhe madhërisë, për muslimanët nga horizonti i lavdisë dhe dinjitetit; le të jetë ardhja jote për tokën paqe dhe mirëqenie, le të jetë shfaqja jote për të gjithë njerëzit përparim,

vëllazëri dhe mëshirë! Eja, nxito dhe shfaqu sa më shpejtë, që njerëzve t'u ofrosh kriter të së vërtetës në vend të kriterit të forcës, që ndërmjet tyre të vendosish ligjin e tolerancës dhe butësisë në vend të ligjit të fuqisë dhe ashpërsisë! Eja dhe ndriçoje Tokën me paqe e dritë, sepse është përplotë padrejtësi, dhunë dhe errësi.

Eja, oj Hënë e re e Ramazanit, ndriçoi me të madhe të gjitha viset e botës islame dhe lëshoi mbi bijt e tyre rrezet e dritës dhe frymëzimit, e cila do t'i shpie dhe do t'i për-cjellë në çdo vend, rreze që do të depërtojnë thellë në zemrat e tyre kur janë të vetmuar dhe kur janë në shoqëri.

Hyn në shtëpitë e Zotit dhe ndriçoi ato me dritë. Lejona që t'i shohim stolitë e minareve në tërë bukurinë e tyre, gjerdanët e ndritshëm të cilët plot mall do t'u bashkohen kandilave qiellorë. Mbaji dyert e tyre të hapura edhe ditën edhe natën, sepse deri tash kanë qenë të hapura vetëm gjatë tubimeve. Mos lejo që për asnjë çast të mbetën të zbrazëta pa musal-li, lexues të Kur'anit, vaizë dhe pa ata të cilët sinqerisht kërkojnë përudhje. Përgatiti ashtu siç kanë qenë që ditën e parë: **“Në xhamitë të cilat me vullnetin e Tij i ngritën dhe në të cilat përmendet emri i Tij – e madhërojnë Atë, mëngjes e mbrëmje,**

njerëzit të cilët shitblerja nuk i pengon që ta përmendin emrin e Tij, të cilët e kryejnë namazin dhe e ndajnë zekatin.” (En Nur, 36-37).

Hidhe pak shikimin tënd edhe në klubet dhe vendet e ndryshme ku muslimanët kot së koti e kalojnë kohën e tyre, vende në të cilat nuk ka kurrfarë të mire pos kuvendimeve që shkaktojnë ngatërresa të ndryshme dhe pëshpëritje të fshehta. Kërko nga ata që t'u shmangen punëve të kota, të folurit jo të denjë, paturpësisë dhe të këqijave, përkujtoi në etikën islame të tubimit: **“O besimtarë, kur midis veti bisedoni fshehtë, mos bisedoni për mëkatin, armiqësinë dhe mosdëgjimin ndaj Të Dërguarit, por bisedoni për mirësinë dhe nderin.”** (El-Muxhadele, 9).

Ktheu pak edhe në tregjet e muslimanëve, tregje ku mbretërojnë zhurma e rrëmuja, zënka e konflikti, tregje në të cilat janë përhapur me të madhe grykësia e lakmia, sjellja e pahijshme e gënjeshtër, mashtrimi e vjedhja në peshë, tregje në të cilat nuk janë të rralla ofendimet dhe betimet e rrejshme...! Ktheu dhe shndriti me ndriçimin tënd të larë, hedh mbi ata pak nga pastërtia dhe fisnikëria jote. Përtërije kontratën e imanit në mënyrë që ata ta zvogëlojnë lakminë e tyre. **“Thuaj: O njerëz, ju e dini se askush nuk vdes derisa**

nuk e harxhon furnizimin e vet dhe nuk i vjen momenti i caktuar. Për këtë kini frikë All-llahun dhe silluni mirë me rastin e fitimit të furnizimit”. Ua përkujto porosinë e kahershme të Të Dërguarit të tyre: **“All-llahu e mëshiroftë njeriun i cili është shpirtmadh kur shet, shpirtmadh kur blen, shpirtmadh kur gjykon, shpirtmadh kur vendos!”**

Eja, oj Hënë e re e Ramazanit dhe vizitoje çdo punëtor, zejtar, gjykatës dhe çdo të punësuar në vendin e tij të punës, ua kthe kujdesin në përkushtimin ndaj All-llahut xh.sh. në punë, ftoi të kenë kujdes për atë që u është besuar dhe ua përcill fjalët e Muhammedit a.s.: **“All-llahu dëshiron që punën të cilën e punoni ta bëni në mënyrën më të mirë”**.

Futu nëpër shtëpi, ndërtesa, kasolla e pallate. Çdo gjëje jepi shenjë të Ramazanit dhe të gjithë përkujtoi në obligimin dhe dobinë nga edukimi në frymën kur'anore. Ndër të gjithë besimdrejtët, sa të jetë e mundur më shumë, barazoi urinë e etjen ditën dhe pijet e ushqimin natën. Mos i lejo askujt që të shtrihet në shtrat i ngopur, ndërsa fqinji i tij ta kalojë natën i uritur, as që ndokush të hajë e të pijë gjatë ditëve të Ramazanit, po qe se është në gjendje që ta përmbushë këtë obligim ndaj Sunduesit të tij.

Na eja, o Ramazan, të gjithëve, individëve dhe grupeve. Zgjoi zemrat tona të përgjumura dhe na i çliro shpirtrat tanë të ngatërruar. Eja dhe përtërije kontratën tonë me Kur'anin fisnik, në mënyrë që të jemi të denjë në punën tonë. Eja o udhëtar fisnik, meqë dëshirojmë të të ofrojmë mikpritje të veçantë...!

Obligimi i agjërimit

O agjërues...!

O ti që agjëron dhe heq dorë nga dëshirat dhe ëndjet tua, ti që vetëdijshtëm i mposhtë nevojat dhe dëshirat e trupit tënd, ti që e kalon ditën i uritur derisa ushqimet e shijshme janë në duart tua, ti që e kalon ditën i etshëm derisa pijet e mira e të lejueshme të shkëlqejnë para syve, më thuaj, për hir të Zotit, për ç'arsye ai flijim, për ç'arsye ai vetëmohim?

Njeriu me arsye të shëndoshë nuk ndër-merr kurrfarë aksioni derisa nuk e kupton qëllimin e tij dhe nuk e përcakton cakun e tij. Po ashtu edhe besimtari nuk punon asgjë derisa nuk e analizon qëllimin e vet dhe nuk e vërteton korrektësinë dhe arsyeshmërinë e tij. A e ke përcaktuar t'i cakun e agjërimit tënd dhe a e ke analizuar qëllimin tënd? Mos vallë agjë-

rimi yt është vetëm traditë dhe shenjë e jashtme e respektit ndaj mendimit publik.

Unë frikësohem që të mos bëhesh rob i çfarëdo traditave, qofshin individuale apo grupe? All-llahu xh.sh. të ka dhuruar zemër dhe arsye që të të udhëheqin dhe Ai nuk dëshiron që t'i zëvendësosh këta udhëheqës të vërtetë me traditat e verbra që të bëjnë vegël të tyre. Ai të ka krijuar që vetë të jeshë sundues i vetvetes dhe që askënd mos ta imitosh. A nuk do të agjërosh sepse të tjerët agjërojnë, a thua do të hash e do të pish pse edhe të tjerët hanë e pinë, e të mos e dinë përse agjërojnë dhe përse hanë e pinë.

Mirëpo, nëse pas të menduarit dhe të gjykuarit me vetëdëshirë je përcaktuar për këtë flijim, atëherë të lutem më thuaj se çfarë dëshiron të arrish me agjërimin?

A thua je i mendimit se agjërimi është pushim për organizmin, rast i volitshëm për përtëritjen e qelizave, se është dietë për trupin? Po ndoshta në të nuk gjen ndonjë përfitim ekonomik ose kursim të kohës, mos vallë në të po e sheh rastin që ta provosh fuqinë, durimin dhe gatishmërinë tënde që të kapesh fyt për fyt me vështirësitë.

O agjërues...!

Unë nuk them se agjërimi nuk duhet t'i ketë të gjitha këto funksione, madje shumë

më tepër nga ato që i cekëm pak më parë, por ta tërheq vërejtjen se agjërimi i mirëfilltë nuk mund t'i ngërthejë në vete vetëm këto, andaj, po ta tërheq vërejtjen se po qe se i bën vetëm këto, nëse kufizohesh në qëllimin e arsyeve të sipërpërmendura, ti në të vërtetë nuk dëshiron asgjë tjetër pos që të bëhesh sportist i mirë, kursimtar i shkëlqyeshëm, njëfarë mjeku i vetvetes që e kërkon rrugën më të lehtë deri te ilaçi, ose të jeshë çfarëdo tjetër, por ti nuk e di se agjërimi vetëm për motive të tilla, nga pikëpamja islame fare nuk të pranohet te All-llahu xhel-le shanuhu.

Për agjërimin në Islam nuk mjafton që të vijë në shprehje vetëm ana pasive materiale që shprehet nëpërmjet vetëpërmbajtjes nga ushqimi, pija dhe thithja e duhanit. Agjërimi para së gjithash është veprim aktiv shpirtëror, me ç'rast ai i cili e kryen dëshiron të arrijë cakun që ia ka caktuar Sheri'ati islam. Për këtë ai për agjërimin edhe e bën nijetin, që është në pajtim me qëllimin të cilin vullneti i Zotit ia caktoi agjërimin. Dije pra, ajo që All-llahu xh.sh. e dëshiron nga agjërimi yt, është që vendimi yt të jetë në pajtim me vullnetin e Tij. Gjëja e parë që do të të kujtohet me atë rast, le të jetë ajo se All-llahu xh.sh. është i mëshirshëm, se Ai me agjërimin nuk synon vuajtjen as vështirësinë tënde dhe se deri te Ai nuk do

të arrijë as rraskapitja por as dobësia e trupit tënd.

Edhe pse ekzistojnë fe dhe mësimet të cilat rekomandojnë vuajtjen e trupit dhe të cilat bukuritë e kësaj bote i konsiderojnë armik kundër të cilit duhet luftuar, Islami nuk u përket atyre, e si do t'ju përkiste kur Kur'ani thotë: **“O besimtarë, mos ia ndalni vetes gjërat e bukura të cilat All-llahu ua ka lejuar.”** (El-Maide, 87) ose: **“All-llahu dëshiron që t'ua lehtësojë, e jo që vështirësi të keni.”** (El-Bekare). Sikur qëllimi i agjërimit të ishte vetëm tërheqja e vërejtjes në urinë dhe etjen, atëherë për njeriun do të mjaftonte të agjërojë vetëm një ditë në vend të numrit të caktuar të ditëve, ndërsa njeriu me oreks të humbur do të duhej të agjëronte më gjatë që ta ndiejë nevojën për ushqim, por ne e dimë se është mëkatar ai i cili agjëron më gjatë dhe nuk han pas perëndimit të diellit, qoftë edhe nëse pushon së agjëruari. Mëkati i tij është i barabartë me të atij i cili agjëron më shkurt dhe që han para perëndimit të diellit. Nga ana tjetër, dimë se ai që i respekton kushtet e agjërimit dhe rregullat e tij, përjeton edhe disa ndryshime në natyrën dhe karakterin e vet.

Domethënë, qëllimi i agjërimit nuk është vuajtja trupore, edhe krahas asaj që disa vështirësi të vogla janë të pranishme gjatë

agjërimin. Kur All-llahu i madhëruar tha: **“Ua kam bërë obligim agjërimin!”**, ajetin nuk e përfundoi me fjalët **“që të vuani”**, **“që të shëroheni”** ose **“që të kurseni”**, por ka thënë: **“që të jeni të devotshëm”**. Ai në këtë mënyrë agjërimin e bëri provim shpirtëror dhe moral. Ai dëshiroi që agjërimi të jetë mënyra përmes së cilës do të hymë në radhën e njerëzve të devotshëm.

Devotshmëria...! Ky është qëllimi i vërtetë i agjërimin dhe nëse këtë e kuptoni ose e pranoni si qëllim kryesor të agjërimin, atëherë pas tij do t'i gjeni edhe të gjitha frytet tjera. Por, nëse gjatë agjërimin ju shpëton devotshmëria, atëherë i tërë angazhimi juaj është i kotë: **“Atij që dëshiron shpërblim në atë botë – do t'ia shumëfishojmë, ndërsa atij që e dëshiron shpërblimin në këtë botë – do t'ia japim, por në atë botë nuk ka hise”**. (Esh-Shura, 20).

E ç'mendoni, ç'është devotshmëria? Ju nuk mund ta kuptoni thelbin e saj as t'ia përcaktoni vendin e vërtetë derisa nuk i dini statutet e qenieve dhe shkallët e ekzistencave. Duhet të dini se ekzistojnë tri shkallë të ekzistencës. E para është **“Shkalla e sundimit absolut”** që i përket një të vetmit All-llah. E dyta është **“Shkalla e nënshtrueshmërisë në këtë botë”**, e kjo

është shkalla e qenieve që u janë nënshtruar ligjeve të natyrës dhe ato nuk kanë kurrfarë lirie, sikur qeniet jo të gjalla dhe shtazët. Po ashtu edhe njeriu lëshohet në këtë shkallë po që se bëhet rob i epsheve të veta. Ndërmjet këtyre dy shkallëve gjendet **“Shkalla që e bashkon sundimin mbi Gjithësinë dhe nënshtrimin ndaj Krijuesit të kësaj gjithësie”**, e kjo është shkalla që i përket njeriut nëse i pranon parimet e larta morale nga ana e Sunduesit të vet dhe që në pajtim me to i udhëzon ushtarët e vet, zemrën e vet dhe organet tjera.

Nëse këta ushtarë i dorëzohen atij dhe bëhet komandant i respektuar në armatën e vet, respektivisht nëse bëhet sundues i mbretërisë së tij të vogël, atëherë e arrin edhe cilësinë e devotshmërisë, bëhet i denjë për udhëheqje të Tokës dhe i nderuar që nënshtrimin e vet ta orientojë vetëm drejt All-llahut, e kjo njëmend do të thotë liri e vërtetë.

Kjo është devotshmëri, e cila sipas dëshirës së All-llahut duhet të jetë fryt i agjërimit tuaj. Ajo, në të vërtetë, është qëllimi i përbashkët i të gjitha ibadeteve dhe nënshtrimeve, por asaj agjërimit i jep një dimension të ri dhe domethënie më të gjerë.

Fakti se agjërimit devotshmërisë i jep një dimension të ri dhe domethënie më të gjerë,

mbështetet në atë se devotshmëria e cila del nga obligimet tjera paraqet përmbajtje nga e ndaluara, derisa agjërimi këtyre ndalesave ua shton një pjesë të re që na mëson si të përmbahemi nga gjërat, përndryshe të lejuara dhe, nganjëherë, si mund të heqim dorë nga ajo që rëndom paraqet mjet për jetë. Nëse ndalesat tjera, në trajtë të maturisë dhe vazhdimësisë, lënë në trashëgimi trajtat e para të devotshmërisë, agjërimi, në manifestimin e singertë të përljes dhe pendimit, i lë në trashëgim aspektet skajore të devotshmërisë.

Agjërimi është forma më e lartë e devotshmërisë dhe vepër e mirë që rangohet në vendin më të lartë të All-llahu xh.sh. Ibadetet tjera kanë veçori interesante që janë të dashura për njerëzit dhe që atyre u ofrojnë një natyrë të shëndoshë. Kështu, për shembull, në namaz arrihet ëmbëlsia e duas (lutjes) dhe dialogut-të heshtur, në zekat arrihet kënaqësia që e ofrojnë bujaria dhe fisnikëria, ndërsa në haxh arrihet madhësia e fuqisë, unitetit, solidaritetit dhe njerëzishmërisë. Sa i përket agjërit, atë natyra nuk e nxit, shpejton, por përkundrazi, i kundërvihet. Pikërisht për atë se kërkon vetëpërmbajtje dhe flijim, agjërimi edhe është vepra më e mirë e cila shpëton nga mëkati. Me siguri për këtë shkak agjërimi edhe shpërblehet me shpërblim të jashtëza-

konshëm dhe shumëfish më të madh në krahasim me ibadetet tjera. Në të vërtetë, shpërblimi për një punë të mirë shumëfishohet prej dhjetë deri shtatëqind herë, ndërsa shpërblimi i agjërimit nuk ka as fund as numër, siç është e theksuar edhe në hadithin kudsij: **“Çdo punë e njeriut i përket atij, përveç agjërimit. Ai është Imi dhe Unë për të shpërblej”**. Argumentin për këtë e gjejmë edhe në Kur’anin fisnik: **“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të jenë tejet të shpërblyer.”** (Ez-Zumer, 10).

Kjo vlerë që s’mund të matet, siç kemi thënë, i përket atij që e kupton urtësinë e agjërimit, që është plotësisht i bindur në qëllimin e vet dhe e bën maksimalisht të pastër, ndërsa pastërtia kulmore është pastërtia e të zgjedhurve që manifestohet me flakjen e luksit dhe jetës në komoditet, ashtu që kur të paraqiten situata në të cilat eventualisht do të duhej të flijojmë çdo gjë për idealet e mëdha, ne vërtet jemi të gatshëm, sepse tashmë i kemi shijuar durimin, etjen dhe urinë.

Kjo është porosia e këtij mësimi që ka të bëjë me agjërimin.

EDUKIMI DHE MPOSHTJA E VETVETES

Vlerat themelore të agjërimit

Sado që në agjërim ka vetëpërmbytje dhe sprovë të ndryshme, megjithatë ato nuk janë qëllimi i tij, meqë ai është mënyrë dhe mjet për realizimin e qëllimeve fisnike. Agjërimi është ushtrim i sundimit të vetvetes dhe udhëheqje e vetvetes. Ai është përmbajtje nga dëshirat dhe epshet e shpirtit. Derisa nuk ke agjëruar ti e ke ruajtur organizimin tënd nga futja e të palejueshmes dhe asaj që i bën dëm. Mirëpo, sot kur agjëron, ti e privon veten edhe nga e lejueshmja. Dje je përmbajtur që mos ta qortosh dhe mos ta ofendosh dikë, e sot madje ke kujdes që mos të përgjigjesh as në provokimet dhe ngacmimet e ndryshme, prandaj, nëse dikush të provokon ose të nxitë, ti nuk do t'i thuash asgjë më tepër se: **“Unë agjëroj, unë agjëroj!”**. Në këtë mënyrë përmes agjërimit ti e mban nën kontroll litarin e epsheve, pasioneve dhe të urrejtjes. Agjërimi, në të vërtetë është durim që shpie kah durimi i përhershëm, fitore që shpie kah fitorja përfun-

dimtare dhe e plotë. Nëse agjërimi të cilin vetë e ke zgjedhur të mëson të jeshë i durueshëm në kohën që e karakterizojnë siguria dhe mirëqenia, do të jeshë më i aftë dhe më i gatshëm për durim edhe në fatkeqësi, vështirësi, në luftë dhe në të gjitha rastet tjera. Nëse agjërimi të mëson se si ta mposhtish veten, bëhesh edhe më i gatshëm që nesër ta mposhtish edhe armikun. Ky është rezultati i devotshmërisë, për të cilën All-llahu xh.sh. e ka caktuar agjërimin.

Qëllimi i sipërtheksuar ende gjendet në gjysmë të rrugës, të cilën All-llahu ua ka trasuar atyre që agjërojnë. Pos këtij synimi ekzistojnë edhe qëllime të tjera, shumë më të rëndësishme dhe më madhështore.

Me të vërtetë, sikur e gjithë ajo që kërkohet nga agjëruesit, qoftë që të përmbahen nga dëshirat, epshet, pasionet, mallëngjimet dhe iritimet, e nëse nuk do të ekzistonte kurrfarë aktiviteti i ri pozitiv që e plotëson këtë zbrazëtirë, agjërimi, nga njëra anë, do të paraqiste zvogëlim të fuqisë punëtore dhe, nga ana tjetër, ajo fuqi me asgjë nuk do të kompensohej e as nuk do të shpejtohej. Pra, do të ishte, sipas vlerësimit të disa mentarëve, **“i zbrazët”, “pa dekor”, ose “tregti e cila nuk do të pësojë humbje, por e cila nuk sjell as profit”.**

A do të thotë kjo se institucioni i agjërimit në Islam ka një pasqyrë aq të mjerë e të zbehtë? Jo, kurrsesi! Institucioni i agjërimit është ibadet nga të dy anët. Ana e tij e parë është vetëm hyrje në të dytën. Ky është dru, trugu i të cilit është durimi. Mirëpo, All-llahu xh.sh. nuk dëshiron që ai i cili agjëron ta lërë këtë trung pa fryte, por dëshiron që te ai t'i kultivojë degët e falënderimit dhe që kurorën e tij ta stolisë me gjethe dhe me frytet e dhikrit dhe përsiatjes. Me të vërtetë, ai i cili mendon për fjalën devotshmëri, me të cilën Kur'ani e ka shprehur urtësinë e agjërimit, do të vërejë se ajo në vete i përmbanë këto dy anë.

Devotshmëria në pjesën e vet të parë paraqet abstenim, lëshim, largim dhe vetëpërmbytje, ndërsa në pjesën e dytë ajo është dalje, afrim dhe ngritje. Pra, nuk mbështetet qëllimi kryesor në atë që ai i cili agjëron t'ua mbyllë vrimat shqisave të veta dhe ta heshtë zërin e epshit në vete, e kjo do të thotë mbyllje e derës xhehennemit, por në atë që mbyllja e vrimave të shqisave njëkohësisht të nënkuptojë hapjen e shtigjeve të shpirtit dhe që heshtja e zërit të epshit të jetë jehona e zërit të të vërtetës, e këta janë çelësat e xhennetit. E kush, nga ana tjetër, dyshon në atë se kjo anë pozitive nuk është synimi kulmor i agjërimit, le ta lexojë Librin e Zotit dhe për këtë do

të gjejë dëshmi në ajetet që flasin për agjërimin, le ta studiojë Sunnetin meqë në të do të ndeshet me fjalën e qartë dhe me praktikën e përpiktë të Të Dërguarit.

Islami e ka bërë Ramazanin kohë të jashtëzakonshme kur shpirtrat dalin pas veleve të veta në dy dyer, në derën e humanitetit dhe derën e devotshmërisë. Kur është fjala për daljen e shpirtit në derë të humanitetit, Islami na mëson se modestia jonë në të ushqyer gjatë kohës së Ramazanit nuk guxon të shndërrohet në kursim e grumbullim, por në devotshmëri dhe dhënie. O agjërues, mos e shuaj vetëm urinë dhe etjen tënde, shuaje urinë dhe etjen edhe të të tjerëve! Kjo është domethënia e agjërimit si e ka kuptuar I Dërguari ynë. Ai gjatë Ramazanit ishte edhe më bujar. Pikërisht për atë, Zekatu-l-fitri në fund të Ramazanit nuk është asgjë tjetër pos hallka përfundimtare dhe manifestimi i përbashkët publik i këtyre formave individuale të devotshmërisë, në të cilat durimi shndërrohet në falënderim dhe pajtim me përudhjen e Kur'anit të ndershëm: **“Dhe që të jeni mirënjohës.”** (El-Bekare, 185).

Dalja e shpirtit në dyert e devotshmërisë gjatë Ramazanit, shihet në atë që Islami në të i ka hapur shtigjet e njohura të devotshmërisë, si madhërimin, falënderimin, lavdërimin dhe

lartësimin: **“...dhe që All-llahun ta madhëroni për atë se ju ka përudhur në rrugë të drejtë!”** (El-Bekare, 185). Pastaj të drejtuarit, dua ja dhe lutja penduese: **“E kur robtë e mi të pyesin për Mua, Unë jam vërtet afër: i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet!”** (El-Bekare, 186). Pastaj rukui, suxhudi, kijami, vigjëlimi dhe vetëprovimi: **“Kush e agjëron Ramazanin me besim të sigurtë dhe me vetëpërmbytje të vërtetë, do t’i falet e gjithë ajo që ka gabuar më parë.”** (Hadith), ndërsa i’tikafi (izolimi) në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit është pjesa e fundit në këtë udhëtim, udhëtimin drejt All-llahut dhe dorëzimit të plotë ndaj Atij: **“Me gratë tuaja nuk guxon të keni marrëdhënie derisa jeni në i’tikaf në xhamia!”** (El-Bekare, 187).

Kjo pikëpamje e devotshmërisë e arrinë kulmin e vet në dialogun me All-llahun përmes fjalëve të Tij dhe gjatë studimit të Librit të Tij, ashtu siç e kanë bërë këtë njeriu i zgjedhur, Muhammedi a.s. dhe engjëlli i zgjedhur, Xhibrili a.s., sepse ata të dy çdo vit gjatë Ramazanit së bashku e kanë mësuar Kur’anin. Pikërisht theksimi i kësaj lidhjeje të fortë ndërmjet Ramazanit dhe Kur’anit, paraqet një rën nga karakteristikat më të rëndësishme të këtij muaji të bekuar: **“Në muajin e Ramazanit ka filluar Shpallja e Kur’anit, i cili**

është udhërrëfyes për njerëzit, dëshmi e qartë e rrugës së vërtetë dhe e dallimit të mirës nga e keqja!” (El-Bekare, 185). Me këtë na bëhet me dije që pjesën më të madhe të Ramazanit duhet t'ia kushtojmë Kur'anit.

Nëse popujt, të cilët kujdesen për të kaluarën e vet, e kanë traditë ta kremtojnë përvjetorin e kushtetutave të veta, atëherë jo vetëm që nuk do të ishte kurrfarë risie, por për arsye shumë më të mëdha Islami, respektivisht muslimanët, do të mund ta caktonin Ramazanin për kremtimin e përvjetorit të kushtetutës së tyre qiellore, me të cilën All-llahu i mbylli sheriatet dhe i bëri të përkryera e të kompletuara rregullat e sjelljes fisnike.

Gjëja më e mirë që njerëzit e dinë me rastin e shënimit të përvjetorit të kushtetutave të tyre, është që të njëjtën ta shndërrojnë në përtërirje të lojalitetit të tyre ndaj saj, theksim të kujdesit të tyre për të dhe të veprimit sipas neneve dhe dispozitave të saj. Për këtë arsye edhe kremtimi ynë i Ramazanit le të jetë kremtim i Kur'anit që u shpall gjatë tij, kremtim që do të jetë në shenjë të mësimit dhe dëgjimit të Kur'anit, mësimit përmendsh të ajeteve të tij, kuptimit të domethënies së tyre, aprovimit të mirësjelljes kur'anore dhe ndjekjes së parimeve të tij. Bashk me këtë, para syve tanë le të jetë edhe e vërteta dësh-

përuese, se numri i atyre që e mësojnë Kur'anin dhe e dinë përmendsh, nga viti në vit bëhet gjithnjë e më i vogël dhe se numri i atyre që u përmbahen dispozitave kur'anore dhe kufijve të tij është krejtësisht i vogël. Duke u nisur nga kjo të gjithë e kemi për detyrë ta japim kontributin tonë për rritjen e këtij numri. Kur'ani, Kur'ani, o muslimanë! Kini kujdes që mos t'ju ikë kjo pasuri (ky thesar) nga duart! Dine se All-llahu xh.sh. nuk do t'ju dënojë derisa Kur'ani është me ju!

Na e pranofte All-llahu agjërimin tonë dhe ibadetet tona, dhe na bashkoftë nën bajrakun e Kur'anit në Ditën kur çdo popull do të identifikohet me Librin e vet qiellor! Amin!

Duaja (lutja) jonë e fundit është: **“Lavdia i qoftë All-llahut, Sunduesit të botëve.”**

Manifestimi i unitetit

Deri më tani i përpunuam dy tema për zbulimin e fshehtësive të institucionit të agjërimin. Sa i përket temës së parë, erdhëm në përfundim se besimtari nëpërmjet agjërimin e përforcon vullnetin e vet, se në të zbulon mundësi të shumta që të zotërojë me vet-veten. Thamë se ibadetet tjera e zbrapsin nga epshet e ndaluara dhe manifestimi i egër e i

vrullshëm i emocioneve. Mirëpo, ai me agjërime i ngadhënjën madje edhe instinktët e veta të lejuara dhe ndjenjat e pastra shpirtërore. Po ashtu thamë se ibadetët tjera, me maturi dhe vazhdimësi, i ofrojnë format e para të frikërespektit, derisa agjërime, nëpërmjet përrulltësisë, i ofron pikëpamjet e tij kulmore. Në temën e dytë erdhëm në përfundim se ato synime janë vetëm hyrje dhe përgatitje për synimet tjera më të mëdha, më pozitive, konstruktive, ndërtimore. Me vetëkontrollin e ndjenjave, agjëruesi dëshiron t'i hapë shtigjet e shpirtit të vet, ndërsa me heshtjen e zërit të epshit (lakmisë), ai dëshiron që të ai të flasë zëri i të vërtetës dhe akcionit që është në pajtim me të. Për agjëruesin, urtësia me të cilën fillojnë ajetet për agjërime: **"Që të kemi frikërespekt..."**, është vetëm hyrje dhe përgatitje për urtësinë me të cilën përfundojnë: **"...dhe All-llahun ta madhëroni për atë që ju ka përudhur në rrugë të drejtë dhe të jeni mirënjohës!"** (El-Bekare, 185).

Tash kur mbaruam me këto dy tema, të ftoj, vëlla agjërues, në shqyrtimin e temës së tretë, ku do të zbulosh një fenomen tjetër që është i pranishëm vetëm në agjërime e Ramazanit. Ky agjërime, veçohet nga të gjitha llojet tjera të agjërimit në Islam, sepse ai nuk

është veçim i një personi apo grupi, çfarë është për shembull rasti me agjërimin vullnetar (nafile) dhe me agjërimin për kompensim (kefaret). Po ashtu, askujt nuk i është dhënë e drejta ta zgjedhë fillimin dhe fundin e agjërimit, as ta bashkojë e ta ndajë kur dhe si të dojë, por është bërë i obligueshëm për të gjithë muslimanët në një periudhë të caktuar të vitit, me numër saktësisht të caktuar të ditëve, në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë.

Kjo pikëpamje unike dhe gjithëpërfshirëse e këtij institucioni të madhëruar, është shenjë e mjaftueshme se me agjërimin nuk dëshirohet që ai të jetë ushtrim i rëndomtë shpirtëror që e lidhë njeriun dhe Sunduesin e tij, as manifestim i rëndomtë i njerëzishmërisë, bashkëndjenjës dhe gjithëmëshirës në raste individuale dhe në raste të kohëpaskohshme, por dëshirohet që ai, njëkohësisht, të jetë hallkë e cila shpirtërisht i lidhë të gjithë muslimanët, të jetë lidhje e mëshirës e cila prej tyre përbën një trup.

Institucioni i agjërimit, kur kjo është në pyetje, nuk është asgjë e re ndër institucionet e mëdha të Islamit dhe dispozitat e tij praktike. Nëse mendojmë pak më thellë, do të konstatojmë se kjo natyrë e dyfishtë, shpirtshmëria dhe uniteti, është përfaqësuar në të gjitha ob-

ligimet. Madje, edhe ritualet me anë tejet të theksuar shpirtërore, si namazi dhe haxhxi, Sheriati i ka përfaqësuar me elemente, përmbajtje dhe aspekte të reja, të cilat bëjnë që ana e tyre shoqërore të mos jetë aspak më pak e ndershme as më pak e rëndësishme se ana shpirtërore.

Shikoje namazin! Të gjithë ngrihen që të falen, të moshuarit dhe të rinjtë, të pasurit dhe të varfërit, të nënshtruarit dhe sunduesit. Shiko si janë të përzier, si janë të kthyer të gjithë drejt një kibleje, si të gjithë e ndjekin një imam, si janë të gjithë të ngjeshur në radhë, se si lëvizjet, fjalët dhe gjestet i kanë të njëjta; sikur trupat e tyre të jenë shndërruar në një trup të vetëm; sikur veshët, sytë dhe gjuha e tyre të jenë një vesh, një sy dhe një gjuhë.

Shikoi edhe ritualet e haxhxit! Njerëzit nga të gjitha anët e botës vijnë në një vend dhe mbesin gjysmë të zbathur, gjysmë të zhveshur; te ata nuk ka kurrfarë stolish të kësaj bote; te ata nuk ka asgjë përveç teshave (ihramave) që duken si teshat e të vdekurve; dallimet e prejardhjes, fisit, pozitës dhe emrit këtu janë të fshira. Dëgjoji, të gjithë i përsërisin fjalët e njëjta, fjalët e drejtuara All-llahut xh.sh. dhe braktisjes së çdo gjëje përveç All-llahut.

Nëse agjërimin e kundrojmë nga këndi i njëjtë, edhe te ai do të hasim në aspektin e

kësaj kompaktësie, vëllazërie dhe barabarësie islame. Njerëzit agjërojnë së bashku, bëjnë iftar së bashku, nuk ka kurrfarë dallimi ndërmjet tyre...!

Kur të ngrihet bajraku i Hënës së re të Ramazanit lart në qiell, do të shohish se muslimanët në skaj të Lindjes dhe në skaj të Perëndimit qëndrojnë të gatshëm ta fillojnë ushtrimin e disiplinës dhe të regjimit të caktuar. Të gjithë dëgjojnë dhe presin shenjën të bëjnë iftar ose që t'ju shmangen dëshirave të veta. Ata këto përudhje me radhë i dëgjojnë dy herë në ditë, kur të fillojë të zbardhet dita e dëgjojnë shenjën që t'u shmangen dëshirave të tyre, ndërsa kur të perëndojë dielli, e dëgjojnë shenjën që t'u kthehen dëshirave të lejuara. I shikon se si të gjithë në një moment e bëjnë të njëjtën levizje, lëvizje që te ata lë gjurmë që i përcjellin edhe ditën edhe natën. Gjatë ditës nuk e sheh askënd që han dhe pin, ndërsa natën sërish nuk sheh askënd që përmbahet nga ushqimi dhe pija. Regjimi i tyre i jetës merr trajtë të re, aktiviteti i tyre, pushimi, ëndërra, zgjëndërra dhe aspektet tjera të angazhimit marrin rrjedha të reja. Ndoshta shfaqja e Hënës së re në muajin e Shevalit do të thotë ndërprerje e këtij regjimi dhe kthim mënyrës së rëndomtë të jetës, natyrisht me forcë, vrull dhe elan të ri.

Këto janë, siç po sheh, themelet e Fesë Islame dhe institucionet e saj të mëdha. Secili nga këto dy institucione ka nga dy pikëpamje, e para - që besimtarin e lidhë me Sunduesin e tij dhe e dyta - që e lidhë me besimtarët e fesë së tij. Përveç kësaj, çdo institucion është burim i dy dashurive pa të cilat nuk ka emër komplet: *Dashuria ndaj All-llahut dhe dashuria në emër të All-llahut.*

Domethënë All-llahu xh.sh. dëshiron që ibadetet tona të jenë shenjë e unitetit tonë, respektivisht dëshiron që kjo shenjë të shndërrohet në ndjenja që bëhen zjarr dhe dritë, zjarr armiqve dhe dritë miqve. Përbashkësia, gjithëmëshira, ndihma, solidariteti dhe virtytet e ngjashme vijnë në shprehje në çdo ibadet që ka karakter të përbashkësisë, e më se shumti në agjërimit, ku të gjitha zemrat bëhen një zemër dhe të gjithë trupat një trup. Ja, në këtë qëndron vlera e jashtëzakonshme e agjërimit të Muajit të Bekuar të Ramazanit...

Agjërimit dhe vlerat njerëzore

Ajo në çka nuk ka kurrfarë dyshimi është që ana njerëzore, zë vend të lakmueshëm në Islam. Sikur ta pyetnim muslimanin, sadopak të udhëzuar, që shkurtimisht të na thotë prej

cilave elemente përbëhet mendimi islam, do të na përgjigjej me dy fjalë: Uniteti i hyjnisë dhe uniteti i peygamberisë. Përgjigjja është e saktë, por ai në mendimin islam hedh dritë tepër të pamjaftueshme dhe na jep pasqyrën e mentalitetit të muslimanit, bartësi i të cilit, si duket, i është përkushtuar ekskluzivisht Zotit dhe i cili nuk ka kurrfarë lidhje me botën në të cilën jeton, ose ajo lidhje është hedhë në prapavijë dhe është harruar deri në atë masë, saqë në Islam nuk i dihet thelbi i vërtetë.

Feja në trajtën e vet të përkryer paraqet të vërtetën që është në harmoni të plotë me nevojat e shpirtit të njeriut dhe prirjet e tij, e vërtetë që e përcjell çdo hap të tij dhe që e shpie në çdo aksion të tij. Kur e përcjellim aktivitetin e shpirtit të njeriut, shohim se ai zhvillohet në dy drejtime të ndryshme: i pari, sikur të mishërohej do të paraqitej me vijën vertikale me të cilën ngjitet kah e Vërteta e shenjtë absolute, dhe i dyti, sikur ai të mishërohej do të shfaqej në trajtë të rrethit në sipërfaqen horizontale, i cili shpirtin e lidh me familjen e gjithmbarshme njerëzore, anëtar i së cilës është edhe vetë ai.

Analiza e gjerë e fesë në tërësi do të duhej ta përcaktojë qëndrimin e saj ndaj këtyre dy lidhjeve:

1. Lidhja e njeriut me Sunduesin e tij.
2. Lidhjet e njerëzve ndërmjet veti, si do të duhej të dukeshin ato, dhe
3. Ta shpjegojë qëndrimin e fesë për natyrën e sundimit që i rregullon këto dy lidhje.

Domethënë, simboli i Islamit duhet të përbëhet prej tre elementeve.

Por, ku do ta gjesh këtë simbol të trefishtë të mendimit islam nëse jo në gjuhën e themeluesit të tij! Për atë ta dëgjojmë se si i drejtohet All-llahut me këto tre pohime:

“O Zot, Sundues i gjithçkaje, dëshmoj se Ti je vetëm Një dhe se nuk ke të barabartë me Vetën. O Zot, Sundues i gjithçkaje, dëshmoj se Muhammedi është robi Yt dhe i dërguari Yt. O Zot, Sundues i gjithçkaje, dëshmoj se të gjithë njerëzit janë vëllezër”.

Por, përse të gjurmohet për të kuptuarit e tillë nëpër veprat sunnetike, kur këtë të njëjtën e kemi në Kur'an në tri kaptinat e tij të njëpasnjëshme:

“Dije se nuk ka zot (tjetër) përveç All-llahut!”. (Muhamed, 19);

“Muhammedi është i dërguari i All-llahut.” (El-Feth, 29) dhe;

”O njerëz, Ne nga një mashkull dhe nga një femër ju krijojmë juve.” (El-Huxhurat, 13).

Këto janë, pra, parimet e mëdha të Islamit, e ky është simboli dhe shumëfishi i tyre i përbashkët:

-Besimi i sinqertë në All-llahun xh.sh.

-Lidhja e vëllazërisë midis të gjithë njerëzve dhe

-Kushtetuta qiellore që i rregullon lidhjet tona me All-llahun dhe njerëzit.

E tash fluturimthi ta hedhim një shikim dhe ta krahasojmë këtë simbol të trefishtë të Islamit me simbolin e njohur të cilin shumë kohë më parë e shpiku Revolucioni francez dhe të cilin e përvetësuan popujt tjerë të qytetëruar të botës.

Liria... Vëllazërimi... Barabarësia...!

Para së gjithash, t'i shikojmë të dy simbolet në tërësi! Do të shohim se simboli i Islamit në mënyrë të barabartë i rregullon të dy anët, shpirtëroren dhe shoqëroren, derisa simboli i Evropës bashkëkohore nuk ka lidhje me qiellin dhe është i privuar nga çdo kuptim dhe domethënie shpirtërore. Pastaj, po që se e shikojmë faktorin që është i përbashkët për të dy simbolet, e kjo është ana njerëzore, humane, do të konstatojmë se Islami e jep

nëpërmjet parimit të qartë dhe unik, përderisa ideja evropiane hamendet ndërmjet këtyre tre parimeve, i pari e zbraps të dytin, ndërsa i dyti e shkatërron të parin.

Për atë nëse parimi i lirisë kuptohet në mënyrë të shtrembëruar dhe në kuptimin e vet më të gjerë, ai bëhet pikënisje që nuk di për kufij dhe rrahë, kështu që shkaktohet anarki që nuk i nënshtrohet kurrfarë ligji as rendi. Gjithashtu edhe parimi i barabarësisë nëse kuptohet fjalë për fjale, bëhet ligj i egër e i hekurt, bëhet goditje lirive që nuk përfill kurrfarë dallimi në vlerësim dhe çdo përparësi, edhe në qoftë se ato janë rezultat logjik i dallimeve në kualifikim dhe gatishmëri...!

Mirëpo, në prehër të vëllazërimit islam takohet liria në kuptimin e vet pozitiv dhe konstruktiv, liria pa egoizëm dhe humbje drejtimi, sikur të takohet njëjtësia e cila zë fill në korrektësi dhe drejtësi, njëjtësia pa ekskluzivitet dhe privim.

Kjo është ajo vëllazëri të cilën Kur'ani e bën për lidhje farefisnore ndër të gjithë njerëzit dhe na porositi që maksimalisht ta respektojmë dhe ruajmë.

“O njerëz, frikësojuni Sunduesit tuaj, i cili nga një njeri ju krijoi...!” (En-Nisa, 1).

Ja, këtu qëndron kushtetuta e njerëzisë dhe prej këtu nxirren të gjitha ligjet e saj.

Sikur t'i numëronim të gjitha ligjet në Islam, individuale ose shoqërore, ekonomike ose juridike, politike ose ndërkombëtare, në to nuk do të gjenim asgjë tjetër përpos përpunimit preciz dhe zbatimit të përpiktë të kësaj kushtetute absolute.

Nga kushtetuta për vëllazërinë e të gjithë njerëzve doli ligji me të cilin Islami i fshiu gjurmët e ndasisë dhe i çrrënjosi dallimet në bazë të prejardhjes, kombit dhe racës. Sundesi juaj është Një... Babai juaj është Një... Të gjithë jemi nga Ademi, ndërsa Ademi është nga dheu... Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as i ziu ndaj të bardhit. Përparësia është në devotshmërinë dhe vetësakrificimin: **"Më fisniku tek All-llahu është ai i cili më së shumti i frikësohet...!"** (El-Huxhurat, 13).

Nga kushtetuta për vëllazërinë u krijua ligji për respektimin e të gjitha religjioneve e ideologjive dhe manifestimin e tyre të jashtëm, pastaj liria e mendimit dhe shprehjes së lirë.

"Në fe nuk ka dhunë...!" (El-Bekare, 256).

"Thuaj: Vetëm All-llahut i falem, sinqerisht duke ia shprehur besimin tim, e ju, përveç Tij, faljuni kujt të doni!" (Ez-Zumer, 13-15).

Nga kjo kushtetutë gjithashtu doli ligji i drejtësisë së përkryer, i cili në rregullat e veta

barazon ndërmjet të panjohurit dhe të njohurit, armikut dhe mikut:

“Urrejtja të cilën ndaj disa njerëzve e ndieni, kurrësi mos t’u shtyejë të jeni të padrejtë! Bëhuni të drejtë, kjo është më e afërt me ndershmërinë...!” (El-Maide, 8).

Nga kushtetuta për vëllazërimin e mbarë njerëzisë u nxor edhe ligji për proklamimin e gjërave të lëna amanet dhe për obligimin e dorëzimit të tyre pronarëve, edhe në qoftë se ata e mohojnë vendin, kombin dhe religjionin e tyre:

“Po! All-llahu e do vetëm atë i cili e përmbush obligimin e vet dhe që shmanget nga mëkati!” (Ali Imran, 76).

Nga kushtetuta për vëllazërinë e gjithmbarshme njerëzore u nxor edhe ligji për obligimin e mbrojtjes së armikut, i cili te ne ka gjetur strehim:

“Nëse ndonjëri nga politeistët të lutet për mbrojtje, ti mbroje që t’i dëgjojë fjalët e Zotit, e pastaj përgatite dhe përcille në një vend të sigurt për të!” (Et-Tevbe, 6).

Nga kushtetuta për vëllazërinë e të gjithë njerëzve të botës, doli edhe ligji për përmbushjen e kontratës dhe porosive të kundërshtarëve tanë:

“Dhe përmbushni obligimet në të cilat me emrin e All-llahut jeni obliguar dhe mos

i thyesi betimet pasi fort i keni dhënë, e All-llahun si dorëzan për vete e keni marrë, sepse All-llahu e di atë çka veproni. Dhe mos u bëni si ajo...!” (El-Maide: 91-92).

Nga kushtetuta për vëllazërinë e mbarë njerëzisë është edhe ligji për barabarësinë e të gjithëve kur janë në pyetje ndalesat:

“...Nëse dikush e mbyt dikënd i cili nuk e ka mbytur askënd, ose atë i cili në tokë rrëmujë nuk bën – sikur i ka mbytur të gjithë njerëzit...!” (El-Maide, 32).

Nga kushtetuta për vëllazërinë e gjithmbarshme të njerëzve doli edhe përgjegjësia e shtetit që të kujdeset për qytetarët dhe të garantojë sigurinë e jetës dhe të pasurive të tyre: **“Zotërojnë të drejtat e njëjta sikur edhe ne, por i zotërojnë edhe obligimet e njëjta sikur edhe ne”.**

Nga kjo kushtetutë për vëllazërinë njerëzore u nxor edhe ligji për ndihmën ndaj të varfërve dhe pjesëmarrjen e tyre në pasurinë e të pasurve:

“Edhe ata të pasurit, në pasurinë e të cilëve është pjesa e caktuar për lypësin dhe për atë i cili turpërohet të lypë!” (El-Mearixh, 24-25), respektivisht, pjesëmarrjen e tyre në pasurinë shtetërore:

“...që mos të kalojë vetëm nga duart në duart e pasanikëve tuaj...!” (El-Hashr, 7).

Në mesin e këtij kopshti të vëllazërisë së të gjithë njerëzve të botës, rritet trangu i bekuar i vëllazërisë islame, e cila nuk e rrënon të parën as nuk e kundërshton, aq më tepër, ajo i bashkohet dhe e përforcon. Lidhja e tyre e ndërsjellë nuk është lidhje e armikut dhe mikut, as e të largëtit dhe të afërmit, por kjo më tepër është lidhje e të afërtit dhe të afërmit ose vëllait të lindur dhe vëllait nga babai.

Institucioni i zekatu-l-fitrit

O agjërues, ju përshëndes në ditën kur keni vendosur që me durim të thellë ta agjëroni Ramazanin, ndërsa ju përshëndes edhe në ditën kur me sukses e agjëruat.

Tani do të bëjmë fjalë për gëzimin me të cilin sot jemi të preokupuar. I jemi kthyer mënyrës së rëndomtë të jetesës. Sërish kënaqemi me të gjitha të lejuarat, pasi që me një vendosmëri, sinqeritet dhe besnikëri të thellë e kaluam rrugën e agjërimit. Nuk do t'ju flas për këtë gëzim dhe për ndjenjat e lartësuara shpirtërore si për diç të zakonshme e spontane, por do t'ju flas për qëndrimin e Islamit ndaj saj dhe për mënyrën të cilën na e zgjodhi Islami, e në të cilën duhet ta shprehim atë. Islami nuk dëshiron që ky gëzim të mbe-

tet i mbyllur në ne, as që të manifestohet në mënyrë të ulët e jo të denjë, por kërkon që atë ta shprehim në një mënyrë sa më dinjitoze. Ai assesi nuk lejon që kjo jetë jona e përditshme të shndërrohet në dëfrim të shfrenuar, as në lojë të zhurmshme e të paturpshme, por shpreh dëshirën që të manifestohet në dy mënyra fisnike: shpirtërore, me të cilën i drejtohem All-llahut me dhikër, falënderim, tekbir dhe dua, dhe njerëzore, ku u drejtohem njerëzve duke u solidarizuar me ta, duke i kuptuar, respektuar dhe ndihmuar.

Nuk do të flasim për anën shpirtërore, sepse shohim se grupe të tëra me dhikër e dua e madhërojnë emrin e All-llahut, por do të flasim për anën njerëzore, e cila më të vërtetë i konfirmon të dy këto anë, e cila nga pikëpamja islame ka një rëndësi të madhe dhe ka një domethënie të thellë në jetën e botës muslimane, e ky është institucioni i Zekatu-l-fitrit, institucion të cilin Islami e obligoi nga fundi i Ramazanit. Ky është institucion i madh dhe nuk dëshiroj të them se është unitar në legjislaturën botërore, porse nuk ka të ngjashëm as në vetë legjislaturën islame. Kjo është kështu sepse zekati është obligim i njerëzve të pasur, ndërsa Zekatu-l-fitri, te pjesa dërrmuese e imamëve, është obligim i barabartë i pasanikëve dhe varfanjakëve,

meqë pasaniku solidarizohet me varfanjakun, ndërsa varfanjaku solidarizohet dhe ndihmon varfanjakun edhe më të madh se vetë ai. Pasi durimi dhe modestia bëhen obligime të muslimanëve gjatë Ramazanit, ashtu edhe obligimi i dhënies dhe bujarisë i përfshinë të gjithë: **“Pasaniku le të harxhojë sipas pasurisë së vet, ndërsa ai i cili është në skamje – sipas asaj sa i ka dhënë Zoti...!”** (Et-Talak, 7), dmth. ashtu siç janë barazuar muslimanët në etje e uri gjatë Ramazanit, ashtu edhe sot së paku përafërsisht, të gjithë duhet të barazohen në bollëk, ushqim dhe pije. Kjo edhe është ana praktike e mirënjohjes, derisa namazi i Bajramit dhe tekbirët që lexohen me atë rast, paraqesin formën e njëmendtë të mirënjohjes. Por, a e dini se fjala e mirë përpigjet që të ngrihet në qiell, ndalet në rrugë dhe pret të ndihmohet me ndonjë vepër të mirë, e nëse nuk i arrin ndihma, i kthehet pronarit të saj, e nëse ndihma i arrinë, ajo ngrihet deri te Sunduesi i madhëruar?

“Te Ai ngrihen fjalët e mira, dhe veprën e mirë Ai e pranon!” (El-Fatir, 10).

Ju bëj thirrje që së paku të mendoni për sekretin e këtij institucioni, në mënyrë që të shihni se ai është institucion ideal që krijon shoqëri ideale. Shikoje këtë ushtrim praktik të unitetit dhe barabarësisë dy herë; një herë kur

të gjithë të abstenojnë që së bashku me fat-keqët ta shtojmë varfërinë, dhe hera e dytë, kur të gjithë të kapen për duar, duke u ndihmuar mes veti, që të ngrihen mbi varfërinë. Në këtë mënyrë Bajrami është ditë e gëzimit dhe haresë. A thua bajramet tona vërtet janë festa të gëzimit e haresë?

Si do t'i jetë dita e gëzimit dhe haresë atij, sytë e të cilit mbushen plot lot nga skenat e të mjerëve, veshët e të cilit i dëgjojnë lutjet e lyp-sarëve, ndërsa zemra i lëngon nga dhembja për ta? Jo, Islami kërkon që sot mos ta dëgjojmë vajin dhe mos ta shohim të uriturin e të zhveshurin. Ai na thotë: **"Mos lindtë dielli i ditës së sotme, nëse në ndonjë shtëpi në afërsinë tuaj ka ndonjë të uritur, ose nuk ka çka të mbathë, apo nëse në ndonjë rrugë ka ndonjë që lyp ose nuk është i furnizuar."** Gëzimi duhet t'i përmbushë të gjitha zemrat dhe buzëqeshja të shihet në çdo fytyrë. Sot çdokush duhet ta ndiejë krenarinë dhe madhërinë...!

Ky është mësimi i Islamit në domethënien e vet të fjalëpërfjalshme dhe thelbësore, shpirtërore...!

E tash po ua shtroj një pyetje të gjithë atyre që janë përgjegjës në shoqërinë tonë, në të gjitha nivelet. Ç'kemi bërë praktikisht për sendërtimin e këtyre parimeve të larta? Deri

kur do të lejojmë që fatkeqët dhe të nevojshmit të na trokasin nëpër dyer, t'i ndalin kalimtarët në rrugë dhe t'ia prishin disponimin xhematit në dyert e xhamive? Kjo është një pasqyrë e shëmtuar për shoqërinë dhe bashkësinë islame, ndërsa në Ditën e Bajramit është një turp i madh.

Islami na e trasoi rrugën e madhërisë dhe dinjitetit njerëzor. A ekziston atëherë ndonjë mjet i qëlluar, i cili edhe më tej do ta hapë këtë rrugë? Pyetja mbetet e hapur për shoqëritë humanitare, për të gjitha organizatat e saj si dhe për pushtetet e vendeve islame. Obligim parësor i tyre si dhe obligim yni është që të bëjmë përpjekje maksimale për sendërtimin e këtij synimi, me ofrimin e organizuar, të përhershëm e sistematik të ndihmës sa më të madhe fatkeqëve, e para së gjithash me ofrimin e përkrahjes për zgjidhjen permanente të çështjes së ekzistencës së tyre.

Agjëruesi ka dy gëzime

Ndërrohet faqja e Ramazanit. Tregu i cili ishte mjaft i pasur dalëngadalë zbrazet. Kush fitoi, fitoi, e kush humbi, humbi.

Sot për askënd s'është turp që në cilëndo kohë të ditës ose të natës të kënaqet me begatitë e lejuara të kësaj bote.

I shikon ata që kanë agjëruar dhe ata që kanë ngrënë, e të duket sikur të gjithë janë të njëjtë: Por, a janë vërtet të njëjtë?

Para se të japim shenjë në disa dobi të cilat i kanë agjëruesit nga agjërimi, nga të cilat joagjëruesit janë të privuar, duhet tërhequr vëmendjen në një anë pasive të agjërimin, por anë e cila është tejet e rëndësishme, kështu që ata të cilët kanë agjëruar, plotësisht kanë të drejtë ta fusin në bilancin e tyre, e kjo është ana e sigurisë nga rreziqet e rrejshme me të cilat kanë qenë të frikësuar. Në fillim të Ramazanit atyre u është thënë se fizikisht do të dobësohen, se do të vdesin nga uria, se do të shkatërrohen nga etja dhe se do të shtrihen nga sëmundja...! Mirëpo, shikoi sot! Nuk vdiqën nga uria, nuk u shkatërruan nga etja e nuk i sulmoi as s'i shtriu sëmundja, siç patën parashikuar zemërkëqijtë. Ata parashikimin e pavend të tyre e shndërruan në forcë, kështu që nga kjo betejë dolën të shëndoshë dhe fitimtarë.

Kjo ishte begatia e sigurisë, e tash shikone begatinë e dobisë, fitimit.

Besimtarët nga kjo përvojë dolën më të vendosur dhe më të fortë. Ata janë të gatshëm

që të kapen fytafyt me problemet jetësore dhe me shpresa më të mëdha për fitore hyjnë në luftë me vështirësitë. Materia është orvatur t'i mposhtë, por ata e ngadhënjyen atë; epshet dëshiruan t'i nënshtrojnë, por ata i nënshtroan ato. Ç'mund t'u dalë atëherë sot atyre përpara?

Ai që nuk e ka përjetuar përvojën e agjërimit, as nuk i ka shijuar ëmbëlsitë e kësaj fitoreje. Por për cilën fitore bëhet fjalë? Kjo fitore është më e madhe nga cilado fitore tjetër. Fitoren që e fiton ndaj armikut tënd dhe aleatëve të tij, është fitore më të cilën duhet të krenohesh. Mirëpo ajo, në krahasim me fitoren për të cilën bëjmë fjalë, është shumë më e vogël, sepse kur i kundërvihesh armikut e vë në gatishmëri të plotë gjithë potencialin tënd të forcës: arsyen, zemrën, epshin, urrejtjen, ndjenjat dhe vetëdijen, e kur t'u kundërvihesh epsheve dhe tekeve tua, atëherë shumica e këtyre forcave të tradhtojnë, të braktisin dhe të lënë të vetmuar në fushëbetejë, përveç besimit dhe ndërgjegjes. Kur t'i mposhtish epshet tua, atëherë dëshmon se te ti ekziston fryma e lartë qiellore dhe se në ty gjendet njëri nga ushtarët e Zotit.

Agjërimi është ndjenjë përgjegjësie. Ai është ndjenjë suksesi në punë dhe dëshirë që të jemi të tillë në çdo detyrë. Ai është ndjenjë

e kënaqësisë në kraharor, ngrohtësisë në zemër dhe bukurisë në sy...! Për këtë, kur të bëjë iftar agjëruesi i ndjenë të gjitha këto kënaqësi, kënaqësinë e sigurisë dhe shëndetit, kënaqësinë e fitores ndaj epsheve, kënaqësinë e suksesit në punë dhe shumë kënaqësi të tjera... Të gjitha këto dhe kënaqësitë e ngjashme paraqesin vetëm njërin nga dy gëzimet e agjëruesit, edhe atë gëzimin që është më pak i vlefshëm. Gëzimi i dytë i madh që mbetet për më vonë, është gëzim i cili është e pamundur të përshkruhet, as që dikush mund t'ia përcaktojë vlerën e vërtetë përpos Krijuesit të botëve.

Në një hadith kudsij thuhet se All-llahu i lartësuar ka thënë: **“Shpërblimi për të mirën që e bën njeriu shumëfishohet prej dhjetë deri në shtatëqind herë, përveç agjërimit. Agjërimi më takon Mua dhe Unë për të posaçërisht shpërblej, sepse njeriu vetëm në emrin Tim u shmanget pijeve dhe ushqimit. Agjëruesi ka dy gëzime, një kur han dhe tjetri që duhet ta përjetojë në botën tjetër, është gëzimi i takimit me Sunduesin.”**

Ne themi se gëzimin e parë e kemi sendërtuar, e sa i përket gëzimit tjetër, atë e presim dhe fuqimisht dëshirojmë nga All-llahu xh.sh. ta përmbushë dhe sëndërtojë.

“Thuaj: Për atë le t'i gëzohen bekimit dhe mëshirës së All-llahut, kjo është më mirë nga ajo çka grumbullojnë”. (Junus, 58).

PËRKUJTIMET

Libri i Zotit

Nuk ka dyshim se Ramazani është muaji i përkujtimeve... Në këtë muaj fisnik u zhvillua Beteja e Bedrit, e cila në të vërtetë ishte çasti vendimtar ndërmjet idhujtarisë dhe imanit, lajthitjes dhe përudhjes, të keqes dhe të mirës, të pavërtetës dhe të vërtetës. Në këtë muaj është çliruar qyteti i Mekkes, me çka është siguruar fitorja e imanit dhe të vërtetës dhe me të cilën i Dërguari i Zotit e proklamoi politikën e dashurisë, pastërtisë dhe paqes. Në këtë muaj fisnik është edhe Nata e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj të tjerë dhe në të cilën njerëzve u ndahet mëshira dhe falja e All-Ilahut.

E ndër përkujtimet më të mëdha dhe më madhështore është Libri i Zotit, Librit i të vërtetës që u shpall nga ana e Të Urtit dhe Të Lavdishmit.

Kur'ani fisnik u shpall në muajin e Ramazanit, si përudhje botës dhe dallues i të vërtetës nga e pavërteta, që të bëhet kushtetutë e cila do ta rregullojë jetën e njerëzve dhe do t'i garantojë parimet e larta morale. Për

moralin nuk ekziston kushtetutë më e qëlluar e as më cilësore se Kur'ani. Sikur të caktonim numrin e parimeve të mirësjelljes shoqërore në Kur'an, do të konstatojmë se dy parime janë themelore: parimi i drejtësisë dhe parimi i mirëbërjes. Ç'mendoni, cili nga këto dy parime ka më shumë të drejtë ta prezentojë vlerën dhe cili është më i qëlluar për udhëheqjen politike të shoqërisë?

Është e saktë se çdo parim ka përparësitë dhe mangësitë e veta, çdonjëri ka rekomanduesit dhe ithtarët e vet, ndërsa shumica e hulumtuesve konsiderojnë se dy librat më të hershëm (Tevrati dhe Inxhili sh.p.), në mënyrë tejet rigorozë i kanë ndarë këto dy parime, prandaj Tevrati e ka marrë atë që është më e fortë dhe vendimtare, ndërsa Inxhili atë që është më e butë dhe mëshiruese.

Pa marrë parasysh atë sa është kjo ndarje e saktë ose jo, Kur'ani i ndershëm që i unjësion të gjitha vlerat e mëhershme dhe që në mënyrë koncize i shpjegon parimet e njohura të mirësjelljes pozitive, i jep të dy këto parime në një kontekst, duke i flakur kundërthënien dhe rivalitetin eventual që ekzistonte midis tyre dhe duke ia përcaktuar secilit prej tyre fushën e tij të veprimit dhe kompetencës.

Sa i përket drejtësisë, Kur'ani iu bë pishhtar gjykatësit dhe sunduesit, çdonjërit i cili në

mënyrë të drejtpërdrejtë është përgjegjës për diçka dhe çdo ane të tretë që e merr mbi vete rolin e ndërmjetësit. Po, ky është terren ku asnjë vlerë tjetër përveç drejtësisë nuk ka vend. Këtu nuk ka vend as për mëshirë e as për falje, në të vërtetë, këtu këto dy cilësi do të ishin një e keqe e vërtetë dhe padrejtësi e dukshme. Është e padëshimtë se shumica e ajeteve kur'anore që e lavdërojnë drejtësinë, e madhërojnë, urdhërojnë dhe nxisin në të, janë të theksuara në lidhje me marrjen e aktvendimit të gjykatës dhe me **“shqiptimin e dënimit”**, **“...dhe kur të gjykoni ndërmjet njerëzve, gjykoni drejt!”** (En-Nisa, 58), **“...prandaj, gjyko me drejtësi të njerëzve dhe mos u jep pas ndjenjës...!”** (Sad, 26).

“... nëse binden, atëherë pajtoni ata pa e mbajtur anën e askujt dhe bëhuni të drejtë!” (Huxhurat, 9), **“...por, nëse i gjykon, gjyko drejt...!”** (El-Maide, 42).

Po qe se e përcjellim porosinë e Kur'anit për marrëdhëniet ndërnjerëzore, do të konstatojmë se Kur'ani të hequrit dorë nga e drejta e cila u përket të tjerëve dhe faljen për padrejtësinë e shkaktuar, i bën vlera që meritojnë lavdërim. Mirëpo, kur bëhet fjalë për barazimin e të drejtave dhe përgjegjësitë që dalin nga kjo, nuk e sjell asnjë fjalë të vetme të lavdit.

Këta kufij rigorozë që i ka përcaktuar Kur'ani ndërmjet sferës së drejtësisë e barabërisë dhe sferës së mirëbërjes e mëshirës, i gjejmë plotësisht qartë të paraqitur në problemin konkret të cilin Kur'ani herën e parë e dorëzon në duart e organit kompetent dhe ia urdhëron përpikërinë dhe drejtësinë, ndërsa herën e dytë e lë në duart e atij, e drejta e të cilit është në pyetje, dhe i urdhëron mëshirë e mirëbërje. Ky është problemi i shpifjes ndaj muslimaneve të panjolla, njëherit shohim se si Kur'ani i urdhëron sunduesit që këtë çështje ta marrin me seriozitet dhe vendosmëri të madhe dhe atë që bën shpifje ta dënojë me 80 të rëna. Kurse herën tjetër shohim se si për shembull i urdhëron atij, e drejta e të cilit është në pyetje, që problemit t'i qaset but: **“Mos ta lëshojnë rastin ata që kanë pasuri dhe mjete nga ju, t'u japin të afërmve dhe të ngratëve, edhe atyre që për hir të All-llahut kanë lënë vendlindjen e vet; le t'ua falin dhe mos t'ua zënë për gabim! A dëshironi që edhe juve All-llahu t'ua fal? All-llahu fal dhe është shumë i mëshirshëm.”** (En-Nur, 22).

Mirëpo, këtu tash imponohen dy çështje me rëndësi:

E para:

Nëse është e saktë se shumica e tekstit kur'anor me të cilin lavdërohet dhe urdhërohet drejtësia e theksuar në lidhje me gjykimin e njerëzve, është po ashtu e saktë se në Kur'an ka edhe tekste të tjera që përgjithësisht e udhërojnë drejtësinë dhe nuk e kufizojnë vetëm në rastet e ndarjes së drejtësisë: **“All-llahu urdhëron drejtësi dhe mirëbërje...!”** (En-Nahl, 90), **“... bëhuni të drejtë, ajo është më së afërmi devotshmërisë...!”** (El-Maide, 8). Për këtë arsye shtrohet pyetja përse drejtësinë nuk e pranojmë edhe më gjerë, në mënyrë që ajo të bëhet vlerë me të cilën njeriu frymëzohet në të gjitha kontaktet e tij me të tjerët, të cilën e posedon edhe gjatë të gjykuarit?

Përgjigjja është se këto tekste, madje sikur të merren edhe përgjithësisht me drejtësinë, e cila kërkohet nga ne në mirësjellje, me doemos nënkuptojmë domethënien e saj pozitive, e kjo është dhënia e plotë e të drejtës dhe me asgjë e cenuar atij të cilit ajo i takon, derisa në asnjë rast nuk mendohet në domethënien e saj negative. Kjo do të thotë mungesë e tepricës të cilën ndokush e bën nga mirësia dhe fisnikëria, sepse në rastin kur dëshirohet të ndalohet teprica, atëherë imperativi i drejtësisë do të ishte i pavlefshëm dhe jo i plotë në krahasim me imperativin e

mirëbërjes. Si do të të motivojë Kur'ani që ta marrish të drejtën tënde të plotë, e që njëkohësisht të të urdhërojë që të heqish dorë nga ajo, ta japish si lëmoshë dhe t'ia dhurosh dikujt? Nëse në mirësjellje kërkohet drejtësia, atëherë kjo nuk do të thotë barazim midis asaj që e merr dhe asaj që e jep, sepse me këtë nuk do të cenohet e drejta e askujt, e sa i përket tepricës së pjesës së caktuar që vjen nga fisnikëria dhe mirësia, është në natyrën e drejtësisë së kërkuar që mos ta ndalojë as ta mohojë.

E dyta:

Nëse e pranojmë parimin e faljes dhe mëshirës, parimin e butësisë dhe konsideratës si vlerë e veçantë kur'anore dhe e përvetësojmë si parim i përgjithshëm në marrëdhëniet e ndërsjella midis njerëzve, atëherë kjo automatikisht do të na shpie deri te ajo që ta shfuqizojmë dënimin dhe shpërblimin... Shtrohet pyetja se a është kjo vërtet politikë e shëndoshë mbi të cilën mund të ndërtohet shoqëria, apo ndoshta më tepër do të shpie çorientim? Paramendoje shoqërinë në të cilën cenohen të drejtat, nuk kryhen obligimet, bëhen shkelje të ndryshme dhe shkaktohet padrejtësia, ndërsa anëtarët e saj fshihen njëri pas tjetrit njëkohësisht duke ia falë njëri-tjetrit. A nuk është ky kaos i vërtetë? A nuk është kjo

nxitje tiranëve dhe njerëzve të mbrapshtë që të shkaktojnë rrëmujë? Nëse kjo politikë ka qenë e drejtë për një grup të caktuar dhe për një kohë të caktuar, si do të pranohet ajo për kod të përhershëm botëror? Si do të jetë kjo gjykatë e shenjtë qiellore?

Ngadalë, ngadalë, o ti që shtron pyetje! E ke kapërcyer kufirin në të rrëfyer! Madje, e ke ndërruar një situatë me një situatë tjetër. Ende jemi shumë larg nga ajo që urtësia e Kur'anit ta motivojë për falje keqbërësin aq mizor, të rreptë e shpirtkeq, e të cilin butësia dhe mëshira edhe më shumë e nxjerrin nga takti. Kjo është një vepër e keqe, falja e së cilës nuk është e drejtë as e imja as e jotja, sepse dëmi i saj nuk përkufizohet vetëm në personalitetin tënd apo timin, porse sëmundja e saj, po qe se zgjerohej, do të mund ta shkatërronte mbarë shoqërinë. Heshtja me rastin e deliktit të tillë paraqet delikt sikur vetë ai, ndërsa po qe se hakmerremi, kjo nuk do të thotë hakmarrje ndaj tij, por hakmarrje në emër të drejtësisë së Zotit, në emër të drejtësisë së mbarë bashkësisë njerëzore.

Situata të cilën e theksove, nuk është lëndë shqyrtimi në të cilën ti je njëra nga palët e interesuara, por kjo është lëndë e përfaqësimit, ku ti je mbrojtës i dispozitave të All-llahut dhe nuk lejon që të shkelen ndalesat e Tij. Kjo

është fushë e ndalimit të ndërsjellë dhe kolektiv të të vërtetës. Kjo është pozita e mënjanimit të rrëmujës për të cilën All-llahu thotë: **“Sikur All-llahu të mos i zbrapste njerëzit, njerën palë me të tjerët, më të vërtetë në tokë do të shkaktohej rrëmujë...!”** (El-Bekare, 151). Nuk ekziston droja që falja për ofendim që është shkaktuar ndaj teje të përhapet asisoj. Kjo është falja e mëkatit që bëhet pa qëllim, e këtu butësia dhe mëshira janë ilaçi i vetëm i mirë dhe i dobishëm. Kjo, në të vërtetë, është sikur shkëndija që bie në ujë, me ç'rast bëhet e ftohtë dhe e qetë.

“Të keqën ktheje me të mirë, kështu që armiku yt menjëherë do të bëhet mik yti i sinqertë!”. (Fussilet, 34).

Nata e vlefshme

Nxënësi i tha profesorit të tij: Profesor i ndershëm, na thuani ku qëndron fshehtësia e këtij respekti të madh, me të cilin muaji i Ramazanit dallohet nga muajt e tjerë të vitit?

Profesori: Sepse, **“Në të është shpallur Kur’ani”**, -siç thotë All-llahu xh.sh.

Nxënësi: E mirë, a nuk është shpallur diç nga Kur’ani në ndonjë muaj tjetër pos Ramazanit?

Profesori: Gjithsesi, Kur'ani është shpallur në çdo muaj, por ishte pikërisht muaji i Ramazanit kur meleku, Xhibrili, për herë të parë i erdhi Muhammedit a.s., i cili lutej në shpellën Hira. Kjo ishte kthesa vendimtare ndërmjet dy periudhave dhe pika e parë e mëshirës së All-llahut e cila erdhi që t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, nga lajthitja në rrugën e drejtë, nga fatkeqësia në të mira...! Ky shi fisnik ka rënë 23 vjet, derisa All-llahu nuk e plotësoi fenë e Tij dhe nuk e bëri të përkryer begatinë, duke e përfunduar shpalljen e kësaj këshille e vërejtjeje të urtë... Do të thotë, vetë nisma e shpalljes së Kur'anit ka qenë fryti i parë i kësaj begatie të madhe dhe kujtimi për të është i lidhur me ditën e shpalljes së tij. Për këtë, kur do të vijë muaji i Ramazanit, na kujtohet kjo dhuratë dhe Ai që e dhuroi, duke e shprehur mirënjohjen tonë dhe duke e përtërirë lojalitetin tonë ndaj Atij dhe Shpalljes...

Nxënësi: A mos ky hap i parë i shpalljes kur'anore ka zgjatur gjatë tërë muajit të Ramazanit të parë?

Profesori: Jo, ky ishte vetëm një çast të cilin e lindi muzgu i një nate të tij.

Nxënësi: E përse atëherë ne e festojmë tërë muajin? A nuk mjafton ta festojmë vetëm këtë natë të jashtëzakonshme?

Profesori: A mendon se drita që është shfaqur atë natë ka qenë aq e dobët, saqë nuk ndriçoi asgjë më shumë pos vendit ku u lind? Jo, ajo ka qenë aq e fortë saqë një muaj s'ka mundur ta përfshijë. Ajo, në të vërtetë, e ka përfshirë tërë kohën...!

Nxënësi: Kjo është në rregull, por ne po dëgjojmë se si All-llahu në Librin e Vet e madhëron muajin Ramazan, e nëse netët tjera të Ramazanit e kanë këtë nderë për shkak se gjenden në muajin e natës në të cilën u shpall Kur'ani, a nuk ka qenë atëherë më parësore që Kur'ani ta madhërojë këtë natë sikur që e madhëron tërë këtë muaj?

Profesori: Po, pikërisht kështu është. All-llahu në Librin e Vet një herë e përmend muajin e Ramazanit, derisa natën e njëjtë e përmend dy herë dhe i jep dy emra: "**Nata e bekuar**": "**Ne atë e zbritëm në një natë të bekuar...!**" (Ed-Duhan, 3), dhe "**Nata e vlefshme**", në të cilën është shpallur kaptina në tërësi: "**Ne e shpallëm atë në Natën e Kadrit (të Vlefshme)...!**" (El-Kadr, 1).

Nxënësi: E sa është dallimi në vlerë ndërmjet veprave të mira që bëhen atë natë të vlefshme dhe veprave të mira që bëhen gjatë netëve të tjera të Ramazanit?

Profesori: Këtë do të ta shpjegoj në këtë mënyrë. A nuk e di se vlera e veprës

shumëfishohet me dhjetra ose qindra herë? A do të pajtohesh me mua kur të them se vlera e veprës në Natën e Kadrit e kapërcen vlerën e veprës nga tridhjetë mijë net të tjera?

Nxënësi: Nuk jemi mësuar ta teproni... tridhjetë mijë net? Prej nga kjo te ju?

Profesori: Prej Librit të Zotit. Lexo vetë: **"Nata e Kadrit është më e vlefshme se..!"**, nuk ka thënë **"...se një mijë net, por se një mijë muaj"**.

Nxënësi: A është kjo edhe sot e arritshme, respektivisht për çdo Ramazan? A nuk ka qenë kjo e veçantë për atë natë në të cilën Kur'ani u shpall për herë të parë?

Profesori: Sikur të ishte në lidhje me këtë natë sikur që mendon ti, respektivisht sikur vlera e saj të ishte në natën në të cilën Kur'ani u shpall për herë të parë, atëherë edhe vetë Kur'ani për të do të fliste si për ndonjë ngjarje historike që ka ndodh dhe ka kaluar, pra do të thosha se ka qenë më mirë, se në të kanë zbritur melekët, mirëpo, ai për të flet si për diç që zgjat e përsëritet dhe thotë se ajo është më e mirë, se është paqe dhe se në të zbresin melekët dhe Xhibrili. E kjo do të zgjasë deri atëherë kur në Tokë do të ekzistojë grupi që i përmbahet të vërtetës...! E dimë se Ai alejhis-selam dhe shokët e tij këtë natë të bekuar e kanë kërkuar çdo vit në Ramazan.

Nxënësi: E kanë kërkuar?! A nuk është kjo nata konkrete e njohur nga Ramazani i parë, nata e cila përsëritet në mënyrë mirë të përcaktuar çdo vit?

Profesori: Ajo nuk është cikël mekanik kozmik. Ajo është dhuratë hyjnore, me të cilën All-llahu e bekon atë natë në të cilën dëshiron t'i zbresë melekët dhe Xhibrilin. Nata e parë e Kadrit, që është e para e Shpalljes, ka rënë në natën e shtatëmbëdhjetë të muajit Ramazan, ashtu si e transmetojnë historianët dhe e konfirmojnë komentuesit, duke u bazuar në ajetin e kaptinës **“El-Enfal”**, **“...Nëse i besoni All-llahut dhe asaj që ia kemi shpallur robit tonë, ditën e dallimit të mirës nga e keqja, ditën kur u ballafaquan dy grupe...!”** (El-Enfalë, 41), ndërsa dita kur janë ballafaquar dy grupet, respektivisht ushtritë, ka qenë Dita e shtatëmbëdhjetë e Bedrit. Mirëpo, ajo pas kësaj është translocuar, madje edhe gjatë kohës së Të Dërguarit dhe shokëve të tij kështu që ka rënë në natën e njëzetënjëtë, njëzetetretë, njëzetepestë dhe njëzeteshtatë. Ubejj b. Ka’bi është betuar, siç transmeton Muslimi, se ka qenë natën e njëzeteshtatë. Por, kjo sigurisht ka të bëjë me një vit të caktuar, mirëpo, të gjithë këtë e kanë marrë si kohë të përcaktuar.

E ti, a do të lejoje, sikur kjo natë të binte ditën konkrete e të caktuar çdo vit, t'i drejtohesh All-llahut vetëm në atë ditë, e ditëve të tjera jo? Ç'po të pengon që gjatë netëve të fundit të këtij muaji më me përkushtim ta përkujtosh dhe ta falënderosh All-llahun, dhe të sillesh në mënyrë më njerëzore ndaj krijesave të Tij? Ky është rast i cili meriton konsideratë më të madhe dhe një përkushtim më të thellë. Sa bukur dikush për të ka thënë: **“Ajo është natë e vlefshme në të cilën është shpallur Mus'hafi i vlefshëm. I është shpallur Të Dërguarit të vlefshëm nga populli i vlefshëm. Në të zbresin melekët dhe Xhibrili me lejen e Krijuesit të tyre. Siguria dhe paqja zotërojnë me të deri në gdhirje të agimit.”**

All-llahu në këtë natë të bekuar na dhashtë shëndet, siguri dhe paqe.

Festat islame

Popujt e hershëm festat e tyre i shënonin dhe kalonin në shenjë të argëtimit të shfrenuar, lojës, pijeve, dëfrimit, zhurmës dhe rrëmujës. Ndërkaq, disa religjione të vjetra festat e tyre religjioze i shënonin si rivista të shfrenimit dhe anarkisë morale. Në anën

tjetër, gati krejtësisht të kundërt të spiritualizmit asketik, shohim se disponimi festiv është manifestuar nëpërmjet përsëritjes së përkujtimeve, ceremonive dhe lutjeve të shenjta.

Islami, kufijtë e të cilit janë të mesëm dhe kriteret të drejta, me ardhjen e tij hodhi dritë të re mbi idenë e festës. Ai i largon njerëzit nga shfrenimi material dhe rigorozisht spiritual, duke i marrë anët e mira ndërsa duke i shoqëruar, natyrisht, elemente të reja, ashtu që tërë kjo jep kuptim më të lartë, një pamje më të bukur e më të plotë që është shprehje e pastërtisë, dinjitetit, bujarisë dhe mirësjelljes. Kjo është ideja e festës në Islam.

Gjëja e parë që e karakterizon festën islame është ngjyrosja shpirtërore. Mirëpo, shpirti i tij nuk është memec ose i padëgjueshëm, ai klith dhe është plot hov. Dëgjoje këtë himn i cili shtrihet nëpër rrugë nga goja e atyre të cilët shkojnë ta falin namazin e Bajramit, dëgjoje në xhamia në gojën e musal-live, dëgjoje nëpër shtëpi në ditët e tekberi teshrikut, dëgjoje në Mine nga goja e haxhinjve gjatë kohës së hedhjes së guralecave në xhemret. Kjo është klithmë që del nga shpirti, me qëllim që ta shprehë kënaqësinë dhe gëzimin e përfundimit të rrugëtimit të suksesshëm, rrugëtimit të agjërimit ose haxhit. Ky është simboli i fitores së arritur në rrugën e

kaluar, si dhe simbol i vendimit për vazhdim drejt rrugës së fitores shpirtërore në sprovimet e ardhshme...! **“All-llahu ekber ve li-l-lahi-hamd!”**

Islami kërkon që kjo thirrje shpirtërore të manifestohet në pikëpamjet e dekorit e të bukurisë së jashtme dhe në atmosferën e mirëqenies e komoditetit, natyrisht, me maturinë e nevojshme.

Po, obligimi i shtrëngimit të rripit dhe përmbajtjes është haraç që ka qenë i respektuar gjatë kohës së agjërimit dhe haxhit, por kur të vijë Bajrami mos thuaj se është e lejuar ajo çka ka qenë e ndaluar, por thuaj se është bërë e obligueshme ajo çka ka qenë e ndaluar dhe e ndaluar ajo që ka qenë e obligueshme. Po, sot nuk ka agjërim, sot nuk ka ndalesa të ushqimeve dhe të pijeve të mira e të lejueshme: **“Hani dhe pini të gëzuar për atë që në ditët e kaluara e keni fituar.”** (El-Hakka, 24).

Sot nuk ka ngurrim në dekor kështu që çdokush le të veshë e le të mbathë gjërat më të mirat që i ka dhe në vete le të tregojë shenjën e bekimit të Zotit, sepse kjo është dita e arritjes së bekimeve. Sot nuk ka seriozitet as përmbajtje nga loja dhe argëtimi i lejuar. Autorët e Sunnetit transmetojnë se Enesi r. a. ka thënë: **“I Dërguari erdhi në Medine**

ndërsa medinasit i kishin dy ditë që i kalonin në lojë dhe argëtim dhe pyeti: Ç'janë këto dy ditë? Ata iu përgjigjën se në to kanë luajtur edhe janë argëtuar në periudhën paraislame. Me këtë rast I Dërguari shtoi: All-lahu këto dy ditë ua zëvendësoi me ditë më të mira: me Bajramet e Ramazanit dhe të kurbanit...!”

Muslimi transmeton se Aisheja, radijallahu anha, ka thënë: “I Dërguari hyri tek unë në Bajram e në dhomën time ishin dy robëresha që këndonin. Ai nuk tha asgjë, vetëm u shtri në shtrat dhe e ktheu kokën. Pastaj hyri Ebu Bekri dhe duke më qortuar tha: Fyelli i djallit në shtëpinë e Të Dërguarit, a? Ndërsa I Dërguari iu përgjigj: Lëri, o Ebu Bekër! Çdo popull ka festat e veta, e kjo është festa jonë. Aisheja r. anha në vazhdim tha: Zezakët kanë muzikuar lojëra me mburojë dhe shtizë, e unë e pyeta Të Dërguarin, ndërsa ai më tha: A dëshiron të shikosh? U përgjigja: Po. Atëherë ai më mori dhe më vuri pas vete, ashtu që kam qenë e mbështetur në kraharorin e tij dhe kam mbetur ashtu derisa nuk u mërzita. Më tha: A të mjaftoi kjo? - ndërsa unë u përgjigja: Po!”

Nuk do ta lëshoj rastin që në lidhje me këtë lojë në të cilën u dha shenjë në thënien e

Aishes r.a., të them se kjo nuk është vetëm lojë e lejuar, por, nëse qëllimi është korrekt, është aktivitet në të cilin Islami thërret dhe nxit, siç e nxit shënjimin, notin, kalërimin, vrapimin dhe llojet tjera të sporteve të dobishme, sepse ato atij që merret me to ia ndriçojnë dhe zhvillojnë vullnetin dhe i sigurojnë rezistencë trupit, në të vërtetë prej tij bëjnë njeri të fortë, ushtar i cili është i gatshëm ta mbrojë fenë dhe atdheun. E ne kemi nevojë të madhe që gjatë kohës së festave tona, t'i gjallërojmë këto tradita të bukura.

Kështu në festat islame takohen spiritualiteti i hovshëm e i lartë dhe dobia e materialiteti i bukur, i pastër e i padjallëzuar. Mirëpo, Islami nuk kënaqet vetëm me këto dy elemente të festave të veta, prandaj i forcon edhe me elementin e tretë, më të fortin dhe për Islamin më të dashurin. Ajo është ana sociale-humanitare e cila nëpërmjet inkuadrimit të institucionit të zekatit në Bajramin e Ramazanit dhe të sakrificës së kurbanit në Bajramin e kurbanit, nga i gjithë populli bën një trup: **“Prandaj falu dhe ther kurban...!”** (El-Kewther, 2), **“Ka shpëtuar kush është pastruar dhe e përmend emrin e Zotit të vet dhe falet,”** (El-A'la, 14-15).

Shpeshherë me penë dhe me fjalë u kam bërë thirrje vendeve islame dhe institucioneve

të tyre sociale, që në mënyrë të organizuar t'i qasen tubimit të këtyre mjeteve materiale të shpërndara anekënd vendeve të ndryshme dhe t'ua shpërndajnë atyre, e drejtë e të cilëve është, e pastaj ajo që mbetet të deponohet në projekte të mëdha shoqërore. Shpeshherë kam apeluar te përgjegjësit në Egjipt dhe vendet tjera islame, që veçmas për Bajram ta fillojnë fushatën e cila ka për qëllim t'i zbrazë rrugët publike, oborret e xhamive dhe hyrjet e shtëpive nga duart e shtrira të lypsarëve, sepse pozita e mjerë e tyre paraqet turpin tonë që mjegullon bukurinë e Bajramit dhe njëkohësisht është nxitje sistemit ideal që e solli Islami, që popujt të shpëtojnë nga kjo tragjedi.

Më parë kam bërë thirrje dhe kam ftuar, ndërsa sot po e përsëris thirrjen dhe vërejtjen: **“Dhe vazhdo e këshillo, se këshillimi me të vërtetë u bën dobi besimtarëve!”**. (Edh-Dharijat, 55).

Lamtumirë Ramazanit

Kur Ramazani e paralajmëron shkuarjen e vet, ne jemi në gjendje vetëm të themi, Subhanallah! Sa shpejtë po shkon kjo jetë! Sa shpejtë po kalojnë ditët dhe netët! Sikur të

ishin gjethe vjeshtore të cilat i valëviti era e fatit! E, a thua nuk është e tërë jeta asgjë tjetër pos disa çaste? Po, jeta është vërtet vetëm ëndërr, ndërsa amshimi dhe për-hershmëria i takojnë atij që është i amshueshëm: **“Çdo gjë që gjendet në të është e kalueshme, dhe mbetet vetëm Zot yt, i Madhërishmi dhe i Nderuari!”** (Err-rrahman, 26-27).

Ku na iku muaji i Ramazanit?! A nuk ishte vetëm para disa çasteve me ne? A nuk na i ka mbushur veshët dhe sytë tanë? A nuk ishte ai të folurit e mimbereve tona, dekor i minareve tona, mall i tregjeve tona, lëndë e bisedave, shoqëri e natës e takimeve tona, jeta e xhamive tona? E ku është tash?

Ja atje, po e këput perin e fundit që do ta nxjerrë nga horizonti jonë, ja atje po lufton me frymën e fundit dhe dëshiron ta lëshojë para nesh. Pra, devotshmëria jonë e jashtëzakonshme kaloi, u heshtën zërat e bilbilave nëpër degë...! All-llahut çdo gjë i kthehet.

O Ramazan...!

Sa i madh është ndryshimi ndërmjet dy ditëve tua, ditës së ardhjes dhe ditës së shkuarjes sate.

Të kemi pritur me sy dhe zemër të hapur, të kemi pritur me gëzim, hare dhe shpresë. Kemi dëshiruar të na vijë pastërtia jote në të

cilën do të këndellen shpirtrat tanë, sepse kanë qenë të ndryshkur e të tharë. I jemi gëzuar çastit të ardhjes sate, sepse ajo do të thotë pajtim me Krijuesin tonë, nga i cili një kohë të gjatë kemi qenë të kthyer. Sa kemi dashur të jemi besnikë, sa kemi shpresuar të jemi të fortë në mirëbërësinë tënde.

E sot kur po përshëndetemi me ty, shpirtrat na janë plot frikë e turp, plot keqardhje e pikëllim. Nuk e dimë sa të kemi qenë të besueshëm, nuk e dimë sa e kemi realizuar shpresën tënde. Sikur ta dije si na gjete? Dhe çka më vonë ke marrë me vete nga kujtimet me ne? A e ke pranuar arsyetimin e atyre të cilët kanë kërkuar falje? A je i kënaqur me agjërimin e agjëruesve? A të ka pëlqyer namazi i faltarëve?

Sa i madh është numri i atyre të cilët të janë arsyetuar me punët dhe obligimet e tyre. Sa i madh është numri i atyre të cilët janë arsyetuar me dobësitë dhe sëmundjet e tyre. Por, për Zotin, as trupin s'e kanë patur të sëmurë, as mundësitë të dobëta. Në pyetje është sëmundja e zemrës, poshtërsia e shpirtit dhe mungesa e vullnetit. I ka tradhtuar konsekuenca e tyre, prandaj as që kanë tentuar ta ngadhënjejnë pengesën, por kanë ikur nga fushëbeteja para epopesë lavdiplotë dhe vet-

veten që më herët e kanë gjykuar me shkatërrim.

Lërinë tash le ta ndiejnë pikëllimin e dhembjes dhe le ta gëlltisnin zemërimin e pendimit, kur të shohin se shokët që janë ballafaquar me sprovimin, nga i njëjti kanë dalë si ngadhënjimtarë dhe asgjë nuk u ka munguar, në të vërtetë vetëm ua ka përforcuar fenë, fuqinë dhe ju ka treguar se frika e tyre ka qenë vetëm iluzion i thjeshtë dhe mashtrim i djallit.

O Ramazan...!

Thuaju atyre të cilët u mashtruan kësaj here, që mos të lejojnë të mashtrohen edhe herën e dytë! Në lamtumirën tënde thuaju: **“Ai i cili e ka lëshuar rastin në ditët e mia, le ta kompensojë në të tjerat!”**. Thuaju atyre se dyert e pendimit janë të hapura gjerë: **“Ai, i cili bën ndonjë të keqe ose bën mëkat ndaj vetes e pastaj lut All-llahun që t’ia falë, do të bindet se All-llahu fal dhe është i mëshirshëm.”** (En-Nisa, 110).

O muaj i agjërimit, druaj se mos shumë namazfalësve dhe agjëruesve në libërthin tënd u ke shënuar gjëra më të rënda se që u ke shënuar shumicës të cilët nuk kanë agjëruar e as nuk janë falë, sepse ka herë është thënë: **“Shumë mëkate të cilat sjellin përçmim dhe pendim janë më të mira se**

respekti i cili shpie në mendjemadhësi dhe krenari.” Për këtë, nëse joagjëruesit e pranojnë mëkatet e tyre dhe vendosin të jenë më të vendosur, kanë të drejtë që me pendim t’i drejtohen All-llahut xh.sh. E sa u përket atyre mendjemëdhënjeve, të cilët konsiderojnë se me largimin nga ushqimi dhe pijet i kanë plotësuar të gjitha obligimet dhe detyrat e tyre ndaj Teje, por gjatë kohës së agjërimit nuk e kanë lënë përgojimin, me të vërtetë janë mëkatarë. Pendimi është larg tyre, sepse ata bile as që konsiderojnë se kanë bërë mëkat.

A nuk e dinë ata se All-llahu, kur fëmijëve ua ka ndaluar që prindërve të tyre t’u drejtojnë çfarëdo fjalë shqetësuese dhe bezdisjeje, me këtë ka dashur që t’i largojë nga llojet tjera të ofendimit dhe dhunës të cilat vijnë pas tyre, dhe se, gjithashtu, kur agjëruesve ua ka ndaluar pijet dhe ushqimet e lejuara, ka dëshiruar që kjo të jetë shkalla kulmore e pastërtisë dhe ngritjes nga të ndaluarit dhe mëkatet të cilat para kësaj i ka ndaluar si mëkate? A është e kuptueshme që agjëruesit t’i ndalohet të përgjigjet në ofendimet dhe shqetësimet, e t’i lejohet që ai të fillojë të ofendojë dhe shqetësojë dikë?

A nuk është agjërimi, siç kemi dëgjuar, pastërtia kulmore? E si do t’i sendërtojë syni-

met kulmore të asaj pastërtie, ai i cili nuk i ka sendërtuar të parat?

Vëllezër agjërues...!

Uluni pak me mua që të riprovohemi para se të pyetemi! A mos kemi harruar se kandari i veprave është i saktë dhe se I Drejti Absolut i sheh të gjithë. Si do të përgjigjeshim sikur të na thuhej: **“Keni llomotitur dhe paturpshëm keni folur gjatë agjërimit. Keni qenë të pakujdesshëm në namaz”**. E kush nga ne nuk ka llomotitur gjatë agjërimit dhe kush ka qenë i pakujdesshëm në namaz?

Shfrytëzoni këto çaste dhe pastroni zemrat tuaja me pendim, ngritni duart tuaja dhe përsëritni pas meje: **“O Zoti ynë, ne dëgjuam një të dërguar i cili na thërriste në besim 'Besoni Zotit tuaj!'- dhe ne besuam. O Zoti ynë, na fal mëkatet tona, zbuti veprat tona të këqija dhe bëna të vdesim me ata të mirët. O Zoti ynë, na jep atë që na e ke premtuar me anë të pejgamberëve Tu dhe mos na pikëllo në Ditën e Kijametit! Ti me siguri e përmbush premtimin tënd”**. (Ali Imran, 193-194).

Përcillne Ramazanin, atë musafir fisnik ashtu si përcillet musafiri i vërtetë. Ta dini se musafiri i vërtetë nuk përcillet vetëm me selame, por me dhurata dhe gjëra të vlefshme. Por, a e dini se cilat janë dhuratat për këtë

musafir tuajin? Zekatul-l-fitri. Ai e pastron agjërimin tuaj, ai i pastron shpirtrat tuaj, ai i pastron punët tuaja...

Ta lusim All-llahun t'i pranojë veprat tona të mira dhe të na shpërblejë me sinqeritet në të gjitha ndërmarrjet tona.

Amin... Amin...!

PASTHËNIE

Përshkrim i shkurtër i jetës dhe veprës së
dr. Muhamed Abdullah Drazit

Dr. Muhamed Abdullah Drazi i përket plejadës së atyre mendimtarëve, të cilët me jetën dhe veprën e tyre kanë lënë gjurmë të thella në teorinë dhe praktikën muslimane.

Për fat të keq, nuk disponojmë me të dhëna të hollësishme që kanë të bëjnë me jetëshkrimin e tij, por edhe ato të paktat mjaftojnë për shkak të veprimit pozitiv të tyre në brezat e ardhshëm.

Dr. Drazi shkollimin fillor, të mesëm dhe atë universitar e kreu në Universitetin e mirënjohur të Kajros, “**El-Ez'her**”, ku ende ishin të freskëta idetë dhe veprat e kolosëve islamë, Muhamed Abduhu-së, Kevakibit, Muhamed Rashid Ridasë, Meragisë e të tjerë. Pas kësaj shkoi në Francë ku brenda një kohe relativisht të shkurtër doktoroi në Universitetin e Sorbonës. Pas kthimit në Egjipt filloi të punojë si profesor në Fakultetin e Gjuhës Arabe në Universitetin “**El-Ez'her**”. Së shpejti u vërejt se në të fshehej një shkencëtar produktiv. Puna e tij u kurorëzua me një varg

suksesesh, si në punën me studentët ashtu edhe në planin e fjalës së shkruar. Për fat të keq, në kohën kur prej tij pritej më së shumti, ai ndërroi jetë. Interesi i tij për diturinë dhe hulumtimet e tij mbetën të papërfunduara, por me një porosi të madhe: Çdoherë dhe në çdo vend duhet dhënë maksimumin! Në atë kohë në Pakistan mbahej Konferenca për Hulumtimet Islame, ku dr. M. A. Drazi ishte ndër pjesëmarrësit më të suksesshëm në këtë tubim, të fundit për të.

Në vazhdim do t'i theksojmë titujt e disa nga veprat më të rëndësishme të tij:

- Vepra "**Lajmi i madh**" flet për Muhammedin alejhisselam, për fenomenin e Vahjit, respektivisht Shpalljes, për domosdonë e besimit dhe për shëmbëlltyrën e Muhammedit alejhisselam në çdo pikëpamje.

- Vepra "**Pikëpamjet e Islamit**" në mënyrë plastike, burimore, shkencore dhe origjinale flet për Islamin dhe shikimin e tij universal mbi botën, natyrën, shoqërinë dhe idenë.

- Vepra "**Feja – hulumtimet hyrëse në të studiuarit e historisë së feve**", autorin na e paraqet si njohës jo vetëm të mesimit islam, por edhe si njohës të shkëlqyeshëm të mesimeve të ndryshme fetare, zhvillimin e tyre historik, thelbin dhe tendencat brenda tyre si

dhe figurat kryesore të këtyre doktrinave dhe tendencave.

Në fund po e përmendim edhe veprën **“Agjërimi – edukatë dhe xhihad”**, të cilën njëkohësisht po ua japim të përkthyer në gjuhën tonë. Kjo vepër për të gjithë ne paraqet freski të rrallë dhe frymëzim të pashtershëm për çdokënd: për të rinjtë dhe të moshuarit, për intelektualët e për shumë të tjerë. Autori, siç mund të vërehet, ka depërtuar në thellësitë e shpirtit të njeriut tonë musliman, në një mënyrë jashtëzakonisht të qëlluar e ka studiuar mentalitetin dhe dobësitë tona, me ç’rast propozon ide konkrete të bazuara në Kur’an, Sunnet dhe në mendjen e shëndoshë.

Kjo vepër e vogël për nga vëllimi, por e madhe për nga porosinë, le të jetë *urim për Muajin e Bekuar të Ramazanit*, me dëshirë që të gjendet në çdo shtëpi dhe në duart e çdo anëtarit të familjes.

U jam mirënjohës të gjithë atyre që ndihmuan në botimin shqip të kësaj broshure të dr. Drazit, duke e përfshirë Botuesin dhe personat tjerë të angazhuar për botim.

(Shënimet janë marrë nga: Dr. M. A. Draz, “Ramazanski post”, Sarajevo, 1980, fq. 2).

Nexhat Ibrahim

PËRMBAJTJA

MUAJI I UDHËRRËFIMIT DHE MËSHIRËS.....	5
Muaji i bekuar.....	5
Pritja e Ramazanit.....	10
Obligimi i agjërimit.....	15
EDUKIMI DHE MPOSHTJA E VETVETES	23
Vlerat themelore të agjërimit.....	23
Manifestimi i unitetit.....	29
Agjërimi dhe vlerat njerëzore	34
Institucioni i zekatu-l-fitrit	42
Agjëruesi ka dy gëzime	46
PËRKUJTIMET.....	51
Libri i Zotit	51
Nata e vlefshme	58
Festat islame	63
Lamtumirë Ramazanit	68
PASTHËNIE	75
Përshkrim i shkurtër i jetës dhe veprës së dr. Muhamed Abdullah Drazit	75

Dr. MUHAMMED ABDULLAH DRAZ
AGJËRIMI
EDUKATË DHE VETËNGADHËNJIM

Redaktor gjuhësor
Jusuf Gashi
Fatmire Ajdini - Hoxha

Korrektor
Hajrullah Hoxha
Fatmire Ajdini - Hoxha

Shtypi:
Focus - Shkup

Boton:
SH.B. Logos-A
II Mak. brigada, Q.T. "Treska" X/7
91000 Shkup
Tel./Fax: (091) 611-508

